FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 9

Tiranë – E martë, 19 janar 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 31.12.2020	Për dhënien e autorizimit ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin për Zhvillimin e negociatave me prodhuesit e vaksinës Anticovid-19, të cilët janë të certifikuar nga Departamenti Amerikan i Ushqimit dhe Barnave (FDA) dhe/ose Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me këtë vaksinë.....	1619
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.1.2021	Për autorizimin e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin për Negociimin e afatit të shpronësimit të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të nevojshme për ndërtimin e Spitalit të Fierit.....	1619
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 18.1.2021	Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar "Për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet Pfizer Export B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik".....	1620
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 7, datë 31.12.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, "Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse", të ndryshuar.....	1620
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 8, datë 31.12.2020	Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave dhe të certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave.....	1626
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 13.1.2021	Për vendosjen e rregullave të hollësishme, në lidhje me standardet e marketimit dhe të tregtimit të vezëve.....	1650
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 269, datë 28.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL" në Shqipëri.....	1657

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 274, datë 28.12.2020	Mbi shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, në lidhje me shtimin e shtojcës E, në rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit nr. 193, datë 24.11.2017.....	1658
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 275, datë 28.12.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për shtyrje të afatit të hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.....	1659
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 643, datë 15.1.2021	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës Pogradec – Tushemisht – Doganë".....	1661

AKT NORMATIV
Nr. 38, datë 31.12.2020

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE ME PRODHUESIT E VAKSINËS ANTICOVID-19, TË CILËT JANË TË CERTIFIKUAR NGA DEPARTAMENTI AMERIKAN I USHQIMIT DHE BARNAVE (FDA) DHE/OSE AGJENCIA EVROPIANE E BARNAVE (EMA), PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME KËTË VAKSINË

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Dhënie autorizimi për zhvillimin e negociatave

Dhënien e autorizimit ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin për zhvillimin e negociatave me prodhuesit e vaksinës Anticovid-19, të cilët janë të certifikuar nga Departamenti Amerikan i Ushqimeve dhe Barnave (FDA) dhe/ose Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me këtë vaksinë, sipas kushteve më të favorshme për Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 13.1.2021

PËR AUTORIZIMIN E AGJENCISË SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN PËR NEGOCIIMIN E AFATIT TË SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË NEVOJSHME PËR NDËRTIMIN E SPITALIT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Autorizimin e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin që të negociojë dhe të nënshkruajë marrëveshje me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që do të shpronësohen për ndërtimin e spitalit të Fierit.

Neni 2

Marrëveshja përcakton të drejtën e përdorimit menjëherë të pasurisë së paluajtshme, pronë private, para përfundimit të procedurës së shpronësimit.

Neni 3

Çdo pronar shpronësohet në përputhje me çmimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Nënshkrimi i marrëveshjes së përcaktuar në nenin 1, të këtij akti normativ, nuk pengon pronarët për kundërshtimin në rrugë gjyqësore të çmimit të shpronësimit.

Neni 5

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 18.1.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR "PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NDËRMJET PFIZER EXPORT B.V. DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 101, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i marrëveshjes

Miratimin e marrëveshjes së nënshkruar "Për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet Pfizer Export B.V., Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik", sipas tekstit bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 7, datë 31.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 5628, DATË 18.11.2016, "PËR MIRATIMIN E RRJETIT TË LINJAVE NDËRQYTETËSE", TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, "Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë.

Neni 1

Neni 1 i udhëzimit ndryshon si më poshtë:

"Qëllimi i këtij udhëzimi është miratimi i rrjetit të linjave ndërqytetëse (kryesore dhe ushqyese), i cili përfshin itineraret e udhëtimit dhe stacionet e qëndrimit, sipas aneksit 1 dhe aneksit 2, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.".

Neni 2

Neni 3 i udhëzimit ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

"1. Linja ndërqytetëse përfshin pikën e nisjes (vendi i nisjes), itinerarin, stacionet e qëndrimit dhe pikën e mbërritjes (vendi i mbërritjes).

2. Transporti në linjat kryesore dhe ushqyese kryhet me ndalime në stacionet e qëndrimit të përcaktuara gjatë itinerarit të linjës për hipjen dhe për zbritjen e udhëtarëve.

3. Pika e nisjes (vendi i nisjes) dhe pika e mbërritjes (vendi i mbërritjes) është qyteti qendër bashkie dhe/ose qyteti që është në përbërje të bashkisë.

4. Subjektet e licencuar për shërbimin e transportit ndërqytetës të udhëtarëve, agjenci për transport udhëtarësh apo turistike, si edhe subjekte të tjera të interesuara që operojnë në zonë/pranë segmentit rrugor ku kalon itinerari i linjës (karburante, pika autoriparimi etj.), me kërkesë të tyre pajisen me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), sipas modelit në aneksin 3, pas konfirmimit nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) për përmbushjen e kritereve/ standardeve teknike të stacioneve të qëndrimit.

5. DPSHTRR-ja përcakton procedurat, kriteret, afatet dhe tarifat për lëshimin e autorizimit (sipas modelit në aneksin 3), për stacione qëndrimi ndërqytetëse.

6. Stacionet e fillimit, mbarimit dhe gjatë itinerarit të linjave ndërqytetëse ushqyese deri në 16 km, si dhe stacionet/terminalet e qëndrimit për hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve të linjave ndërqytetëse kryesore, që ndodhen në territorin nën juridiksionin e një bashkie, caktohen dhe trajtohen nga bashkia përkatëse, duke pajisur me autorizim subjektet e licencuar për këto linja, sipas modelit në aneksin 4.".

Neni 3

Në nenin 6, pika 2 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

"2. Komisioni vlerësues, i miratuar me urdhër të titullarit të autoritetit licencues, bën shtimin dhe heqjen e numrit të orareve të linjave ndërqytetëse, në mbështetje të nevojave të lëvizjes së udhëtarëve, pas kërkesës së argumentuar të bashkisë përkatëse, si dhe kërkesës së subjektit të licencuar në linjën e rregullt ndërqytetëse.".

Neni 4

Shtohet neni 7, me përmbajtje si më poshtë:

"1. Kriteret e miratimit të stacioneve janë si më poshtë:

a) Stacionet e qëndrimit të jenë:

i. në vende të përshtatshme, me hapësirë të mjaftueshme për hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve, si dhe të pajisura me elemente sigurie dhe me sinjalistikën përkatëse;

ii. pranë autostradave/rrugëve interurbane kryesore, sipas itinerareve të përcaktuar të linjave dhe ndalesat të mos jenë më shumë se 5–10 minuta.

b) Nuk lejohet transporti i udhëtarëve ndërmjet stacioneve të qëndrimit, kur këto stacione përdoren si pikë nisjeje dhe si pikë mbërritjeje.

c) Përcaktimi i vendndodhjes së stacioneve të bëhet:

i. bazuar në Manualin e Sinjalizimit Rrugor, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 10.3.2010, "Për një shtesë në vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave 'Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë'", të ndryshuar; dhe

ii. me grup pune, në përbërje të të cilit të përfshihen përfaqësues nga DPSHTRR-ja, ARRSH-ja, auditues të sigurisë rrugore të certifikuar, si dhe nga palët e interesit (bashki/ shoqata transporti).

d) Projektet e zbatimit të vendndodhjeve të stacioneve, para miratimit, duhet të kalojnë procesin e auditimit të sigurisë rrugore, nga ekspertë të certifikuar, bazuar në udhëzimin nr. 9, datë 3.7.2012 "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore".

e) Subjekti merr udhëtarë në stacionet e qëndrimit vetëm për në destinacionin final, duke respektuar itinerarin e linjës, të përcaktuar në licencë, kur shërbimi nuk mbulohet nga transportues me seli në bashkitë ku ndodhen stacionet e qëndrimit.".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Aneksi 3

Letër format A4, 100 – 120 g/m2, ngjyra e verdhë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

AUTORIZIM Nr. _____

PËR
STACIONET E QËNDRIMIT
NË LINJAT E RREGULLTA TË TRANSPORTIT NDËRQYTETËS

Në bazë të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 5628, datë 18.11.2016 "Për miratimin e rjetit të linjave ndërqytetëse", të ndryshuar, lëshohet ky autorizim:

SUBJEKTI: _____

LICENCA: _____

NUMRI NUIS/NIPT: _____

LINJA NDËRQYTETËSE: _____

STACIONET E QËNDRIMIT: _____

_____

Lëshuar, më ___/ ___/ _____

Autorizimi është i vlefshëm deri më ____/__/ _____

_____

Nënshkrimi dhe vula e Autoritetit Kompetent

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Adresa: Rr. "Muhedin Llagani", Nr. 10, Tiranë;
Tel.: +355 68 801 5 833; Fax.: +355 (0)42238175
e-mail:dpshtrr@dpshtrr.gov.al; www.dpshtrr.gov.al

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me marrjen e këtij autorizimi, subjekti mban përgjegjësi për respektimin e kushteve të përcaktuara për ndalesat e kryera gjatë itinerarit të linjës.

2. Autorizimi nuk mund të transferohet nga mbajtësi i saj tek një subjekt tjetër.

3. Ndalesat në stacionet e qëndrimit të mos jenë më shumë se 5–10 minuta.

4. Nuk lejohet transporti i udhëtarëvendërmjet stacioneve të qëndrimit, kur këto stacione përdoren si pikë nisje dhe pikë mbërritje.

5. Subjekti merr udhëtarë në stacionet e qëndrimit vetëmpër në destinacionin final, duke respektuar itinerarin e linjës të përcaktuar në licencë, kur shërbimi nuk mbulohet nga transportues me seli në bashkinë ku ndodhet stacioni.

6. Autorizimi në origjinal mbahet nga subjekti i autorizuar, ndërsa një kopje e njësuar me origjinalin mbahet në bordin e mjetit dhe u paraqitet organeve të kontrollit sa herë që kërkohen.

7. Në rast konstatimi të shkeljeve të kushteve të autorizimit, do të merren masat e parashikuara për pezullimin dhe heqjen e licencës/certifikatës në nenin 19 të Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar.

8. Autorizimi është i pavlefshëm, kur:

   a) ka përfunduar afati i vlefshmërisë;
   b) është hequr nga autoriteti kompetent.

Aneksi 4
Letër format A4, 100 – 120 g/m2, ngjyra e verdhë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA

AUTORIZIM Nr. _____

PËR
STACIONET E QËNDRIMIT
NË LINJAT E RREGULLTA TË TRANSPORTIT
NDËRQYTETËS

Në bazë të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 5628, datë 18.11.2016 "Për miratimin e rjetit të linjave ndërqytetëse", të ndryshuar, lëshohet ky autorizim:

SUBJEKTI:_____

LICENCA:_____

NUMRI NUIS/NIPT: _____

LINJA NDËRQYTETËSE: _____

STACIONET E QËNDRIMIT: _____

_____

Lëshuar, më ___/___/ _____

Autorizimi është i vlefshëm deri më____/___/_____

_____

Nënshkrimi dhe vula e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me marrjen e këtij autorizimi, subjekti mban përgjegjësi për respektimin e kushteve të përcaktuara për ndalesat e kryera gjatë itinerarit të linjës.

2. Autorizimi nuk mund të transferohet nga mbajtësi i saj tek një subjekt tjetër.

3. Ndalesat në stacionet e qëndrimit të mos jenë më shumë se 5–10 minuta.

4. Nuk lejohet transporti i udhëtarëve ndërmjet stacioneve të qëndrimit, kur këto stacione përdoren si pikë nisje dhe pikë mbërritje.

5. Subjekti merr udhëtarë në stacionet e qëndrimit vetëm për në destinacionin final, duke respektuar itinerarin e linjës të përcaktuar në licencë, kur shërbimi nuk mbulohet nga transportues me seli në bashkinë ku ndodhet stacioni.

6. Autorizimi në origjinal mbahet nga subjekti i autorizuar, ndërsa një kopje e njësuar me origjinalin mbahet në bordin e mjetit dhe u paraqitet organeve të kontrollit sa herë që kërkohen.

7. Në rast konstatimi të shkeljeve të kushteve të autorizimit, do të merren masat e parashikuara për pezullimin dhe heqjen e licencës/certifikatës në nenin 19 të Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar.

8. Autorizimi është i pavlefshëm, kur:

a) ka përfunduar afati i vlefshmërisë;

b) është hequr nga autoriteti kompetent.

UDHËZIM
Nr. 8, datë 31.12.2020

PËR KRITERET, RREGULLAT DHE DOKUMENTACIONIN PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE TË CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE[1]

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës; në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar; ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 19.3.2008, "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare të caktuara për këta operatorë", të ndryshuar;

duke përshtatur rregulloret, direktivat dhe vendimet e Bashkimit Evropian, si dhe rezolutat e Forumit Ndërkombëtar të Transportit (ECMT/CEMT) dhe të Kombeve të Bashkuara të zbatueshme në transportin rrugor të mallrave;

me qëllim rregullimin, disiplinimin dhe monitorimin e veprimtarisë që kërkohet të ushtrohet ose që ushtrohet nga subjekte në fushën e transportit rrugor, si dhe integrimin e plotë të tyre në tregun evropian të transportit rrugor, zhvillimin në mënyrë harmonike të rregullave të transportit rrugor të mallrave, zbatimin e legjislacionit social e të sigurisë dhe mbrojtjen e ambientit, nevojën për të standardizuar dhe lehtësuar procedurat administrative, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë nxjerr këtë udhëzim.

KAPITULLI I
QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME

1. Qëllimi

Ky udhëzim përcakton kriteret, rregullat dhe procedurat që kërkohen për trajtimin në përputhje me dispozitat ligjore, të aplikimeve sipas dokumentacionit provues të paraqitur nga subjekte të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, për lëshimin, pezullimin apo heqjen e licencave dhe certifikatave në fushën e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe përcaktimin e rregullave të aplikueshme për hyrjen në treg, si dhe përcaktimin e kushteve nën të cilat transportuesit rezidentë mund të kryejnë shërbime të transportit. Këto rregulla duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kontribuojnë në funksionimin normal të tregut të transportit.

2. Fusha e zbatimit

2.1 Ky udhëzim aplikohet për të gjitha subjektet, të themeluara/vendosura në Shqipëri, të angazhuar ose që synojnë të angazhohen në veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira ose për llogari të vet. Transporti nga subjektet e huaja që kanë si destinacion apo kalojnë tranzit nëpër territorin shqiptar, kryhet bazuar në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera, palë në marrëveshje.

Transporti ndërkombëtar rrugor i mallrave të rrezikshme kryhet mbështetur në ligjin nr. 118/2012, datë 13.12.2012, "Për transportin e mallrave të rrezikshme", si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

[1] Ky udhëzim është përafruar, pjesërisht me:

- rregulloren (KE) nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 tetor 2009, "Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta, në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE" (OJ L 300, 14.11.2009, faqe 51–71), amenduar me Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 613/2012, datë 9.7.2012 (OJ L 178, f. 6, datë 10.7.2012) dhe Rregulloren e Këshillit (BE) nr. 517/2013, datë 13.5.2013 (OJ L 158, f. 1, datë 10.6.2013);

- rregulloren (KE) nr. 1072/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 21 tetorit 2009, "Mbi rregullat e përbashkëta për hyrjen në tregun ndërkombëtar të mallrave" (OJ L 300, datë 14.11.2009, f. 72), ndryshuar me rregulloren e Komisionit (BE) nr. 612/2012, datë 9.7.2012 (OJ L 178, datë 10.7.2012, f. 5) dhe Rregulloren e Këshillit (BE) nr. 517/2013, datë 13.5.2013 (OJ L 158, datë 10.6.2013, f. 1);

- direktivën 2006/1/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 18 janar 2006, mbi përdorimin e mjeteve me qira pa drejtues mjeti për transportin rrugor të mallrave (OJ L 33, 4.2.2006, p. 82–85).

2.2 Licencimi është i detyrueshëm për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e transportit ndërkombëtar rrugor për të tretë ose me qira.

2.3 Llojet e mëposhtme të transportit dhe udhëtimet bosh të kryera lidhur me të tilla transporte nuk kërkojnë pajisjen me licencë dhe janë të përjashtuara nga çdo autorizim/leje transporti:

a) transporti i postës si shërbim universal;

b) transporti i mjeteve që kanë pësuar dëme ose shkatërrime;

c) transporti i mallrave në mjete, masa e lejuar me ngarkesë, e cila, duke përfshirë atë të rimorkiove, nuk i kalon 3.5 tonë.

d) transporti për llogari të vet të mallrave, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. mallrat e bartura janë pronë e subjektit ose janë shitur, blerë, lënë ose marrë me qira, ose prodhuar, nxjerrë, përpunuar ose riparuar nga ndërmarrja;

ii. qëllimi i udhëtimit është të transportojë mallrat në ose nga ndërmarrja ose të lëvizë ato brenda ose jashtë ndërmarrjes për kërkesat e veta;

iii. mjetet motorike të përdorura për një transport të tillë drejtohen nga personeli i punësuar ose vënë në dispozicion të ndërmarrjes nën një detyrim kontraktual;

iv. mjetet që transportojnë mallrat janë në pronësi të ndërmarrjes, janë blerë me këste ose janë marrë me qira, me kusht që në rastin e fundit të plotësojnë kushtet e direktivës 2006/1/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 18 janar 2006, mbi përdorimin e mjeteve të marra me qira pa drejtues mjeti për transportin rrugor të mallrave;

v. një transport i tillë nuk është më shumë se ndihmës për aktivitetet e përgjithshme të ndërmarrjes;

e) transportin e produkteve mjekësore, aparaturave, pajisjeve dhe artikujve të tjerë të nevojshëm për kujdes mjekësor në raste emergjente, veçanërisht për fatkeqësitë natyrore.

Shkronja "d", "iv" më lart nuk do të zbatohet për përdorimin e mjetit zëvendësues gjatë një avarie të shkurtër të mjetit të përdorur normalisht.

3. Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar dhe në VKM nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë udhëzim, ndërsa termat që përdoren në tekstin e këtij udhëzimi, kanë kuptim si më poshtë:

3.1 "Autoritet kompetent" nënkupton organin, i cili ka autoritetin ose i është deleguar autoriteti për lëshimin, pezullimin dhe heqjen e licencave/certifikatave.

3.2 "ADR" nënkupton marrëveshjen evropiane mbi transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme.

3.3 "Certifikatë", dokument që mbahet në një mjet rrugor me motor dhe i jep të drejtën e operimit në transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet.

3.4 "Drejtues mjeti" nënkupton çdo person që drejton mjetin, edhe për një periudhë të shkurtër kohore ose që ndodhet në mjet si pjesë e detyrave të tij, për të qenë në dispozicion për drejtim mjeti, nëse është e nevojshme.

3.5 "Sektori/specialisti përgjegjës" nënkupton një trupë të posaçme, që është përgjegjëse për shqyrtimin dhe përgatitjen e materialeve për lëshimin e licencave, certifikatave etj., sipas procedurave të brendshme të përcaktuara nga autoriteti kompetent.

3.6 Kritere të licencimit janë pjesë e kushteve dhe dispozitave ligjore nga përmbushja e të cilave bazohet dhënia e licencës.

3.7 "Leje/licencë ECMT (CEMT)" nënkupton leje transporti ndërkombëtar multilateral shumëudhëtimësh dhe për një periudhë të caktuar kohe, për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave ndërmjet dy e më shumë shteteve anëtare të Forumit të Transportit Ndërkombëtar (ITF).

3.8 "Mjet" nënkupton një mjet me motor, një trailer/rimorkio, një gjysmërimorkio ose një kombinim të mjeteve të destinuara eksluzivisht për transport mallrash.

3.8.1 "Mjete motorike kategoria N", mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota:

- kategoria N2 janë mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më shumë se 12 tonë;

- kategoria N3 janë mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë.

3.8.2 "Rimorkio kategoria O", janë rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot):

- kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë;
- kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;
- kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;
- kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.

3.9 "Mjet me qira" nënkupton çdo mjet, i cili kundrejt shpërblimit dhe për një periudhë të caktuar kohe, vihet në dispozicion të një subjekti që angazhohet në transportin rrugor të mallrave për të tretë ose me qira, ose për llogari të vet, në bazë të një kontrate me personin juridik ose fizik që vë mjetin/et në dispozicion.

3.10 "Operacion kabotazhi" nënkupton transportin për të tretë ose me qira, që kryhet midis dy pikave të ndryshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në baza të përkohshme nga mjeti/mjetet e një subjekti të huaj, i cili është regjistruar në një shtet tjetër.

3.11 "Pala kontraktuese" nënkupton atë shtet që ka dhënë dakordësinë/pëlqimin për kryerjen e veprimtarisë së transportit, sipas marrëveshjeve dypalëshe, për aq kohë sa kjo marrëveshje është në fuqi.

3.12 "Regjistri Elektronik Kombëtar (REK)" është regjistri ku mbahen/regjistrohen të dhënat për subjektet e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira dhe për llogari të vet për gjithë Shqipërinë.

3.13 "Subjekt" nënkupton çdo person juridik ose fizik tregtar, si edhe çdo term tjetër të përdorur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si: operatorë transporti, ndërmarrje transporti, transportues etj., që ushtron veprimtarinë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave.

3.14 "Shkelje serioze e legjislacionit të transportit rrugor" nënkupton një shkelje, që mund të çojë në humbjen e reputacionit të mirë në përputhje me VKM-në nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar dhe nenin 6, pikat 1 dhe 2 dhe aneksit IV të rregullores (KE) nr. 1071/2009 dhe/ose tërheqje të përhershme të licencës.

3.15 "Transport ndërkombëtar" nënkupton një udhëtim:

a) me ngarkesë, i ndërmarrë nga një mjet, pika e nisjes dhe pika e mbërritjes së të cilit janë në dy shtete të ndryshme, njëri prej të cilëve është shteti palë në marrëveshje, me ose pa tranzit nëpërmjet një ose më shumë shteteve/vendeve të treta.

b) me ngarkesë, i ndërmarrë nga një mjet drejt një shteti palë në marrëveshje ose në një vend të tretë dhe anasjelltas, me ose pa tranzit nëpërmjet një ose më shumë shteteve ose vendeve të treta.

c) me ngarkesë, i ndërmarrë nga një mjet ndërmjet vendeve të treta, me tranzit përmes territorit të Shqipërisë; ose

d) pa ngarkesë, në lidhje me transportin e përmendur në shkronjat "a", "b" dhe "c".

3.16 "Transportues jorezident" nënkupton një subjekt të transportit rrugor i regjistruar në një vend tjetër, palë në marrëveshje.

3.17 "Tranzit" nënkupton pjesën e udhëtimit përmes territorit të një vendi, në të cilin nuk ngarkohen apo shkarkohen mallra.

3.18 "Transport për llogari të vet" nënkupton transportet e kryera për qëllime jotregtare dhe pa qëllim fitimi, nga një subjekt, me kusht që:

a) transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse për subjektin.

b) mjetet e përdorura të jenë pronë e subjektit apo të jenë blerë me këste nga këto të fundit ose të jenë objekt i një kontrate qiramarrje afatgjatë dhe të drejtohen nga një punonjës i subjektit.

3.19 "Vendi i tretë" është vendi i cili nuk është anëtar i sistemit të kuotave CEMT dhe/ose nuk është palë e një marrëveshje dypalëshe.

3.20 "Vendi regjistrimit" është vendi ku është regjistruar mjeti, i cili shquhet edhe në targën e mjetit.

KAPITULLI II
PARIME TË PËRGJITHSHME DHE AUTORITETET KOMPETENTE PËR LËSHIMIN E LICENCËS/CERTIFIKATËS

4. Parime të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave

4.1 Ushtrimi i veprimtarisë në transportin rrugor, sikundër përcaktohet në ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bazohet në parimet:

a) e proporcionalitetit, deburokratizimit dhe uljes së barrierave administrative;

b) e interesave publikë që ato garantojnë dhe mund të jenë: aftësi profesionale apo fizike, përvojë apo njohuri, mënyrë organizimi, zotërimi i një teknike apo teknologjie të caktuar, gjendje apo garanci pasurore, gjendje juridike apo norma të sjelljes e të etikës.

4.2 Transporti ndërkombëtar rrugor i mallrave rregullohet nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe në fushën e transportit rrugor, marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë dhe *acqui* të BE-së. Ky lloj transporti mund të jetë i lirë, pa leje/autorizim, ose i shoqëruar me leje/autorizim, me shtetin përkatës me të cilin do të kryhet transporti dhe/ose tranziti.

4.3 Kabotazhi apo transporti i mallrave ndërmjet dy pikave në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një transportues i huaj nuk lejohet, me përjashtime të veçanta dhe me leje të posaçme të ministrit, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 101, datë 9.2.2011, "Për miratimin e rregullave për lejet e transportit dhe kryerjen e operacioneve të transportit nga transportuesit e huaj, që nuk kanë selinë në Shqipëri (jorezidentë), për mallra dhe udhëtarë".

5. Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës/certifikatës në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti	Autoriteti kompetent	Baza ligjore
Transport ndërkombëtar rrugor i mallrave për të tretë ose me qira	Licencë	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009, i ndryshuar VKM nr. 538, datë 26.05.2009, i ndryshuar.
Transport dypalësh, shumëpalësh dhe për vende të treta (ECMT/CEMT)	Licencë/libri i udhëtimit (karneti)	Shoqata Kombëtare e Transportuesve Ndërkombëtarë Rrugorë (ANALTIR)	Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar. Udhëzuesi/Guida e përdorimit ECMT/CEMT, janar 2014.
	Certifikatë e përputhshmërisë me kërkesat teknike dhe e sigurisë për mjete EURO	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)	
Transport ndërkombëtar rrugor për llogari të vet	Certifikatë	DPSHTRR	Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", indryshuar.
Transport ndërkombëtar rrugor i mallrave të rrezikshme	Certifikatë	DPSHTRR	

5.1 Autoriteti kompetent është përgjegjës për të siguruar zbatimin korrekt të këtij udhëzimi dhe është i autorizuar, për të:

a) kontrolluar aplikimin e bërë nga subjekti.

b) kontrolluar deklarimin e një subjekti nëse është i përshtatshëm dhe i aftë si drejtues i veprimtarisë së një ndërmarrjeje transporti;

c) kryer kontrollet e kërkuara për verifikimin nëse një subjekt kënaq kërkesat sipas pikës 6, të këtij udhëzimi dhe plotëson kushtet e përcaktuara, në përputhje me rregullat për pranimin në profesionin e operatorit të transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave.

d) lëshuar dokumente, si: licencë/ certifikatë / libër udhëtimi (karnetë) për subjekte të angazhuar në transportin rrugor të mallrave dhe të pezullojë ose të tërheqë/anulojë këto dokumente.

KAPITULLI III
KRITERET BAZË TË LICENCIMIT

6. Kriteret e licencimit, kërkesat bazë

Për të ushtruar veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave, e cila është subjekt licencimi/certifikimi, subjektet paraqesin kërkesë pranë autoritetit kompetent, duke provuar se plotësojnë kriteret e posaçme sipas këtij

udhëzimi, kreut II.1 të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar dhe të reflektuara edhe në aneksin 1, të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar, që janë:

- një vendosjeje efektive dhe e qëndrueshme në Shqipëri;
- reputacioni i mirë;
- qëndrueshmëria financiare;
- kompetenca profesionale.

6.1 Një vendosjeje efektive dhe eqëndrueshme në Shqipëri

Për të kënaqur kërkesën e plotësimit të këtij kriteri, një subjekt duhet të:

a) ketë vendndodhjen në Shqipëri, me ndërtesën/ambientin, në të cilin ai mban dokumentet e veprimtarisë së tij, në veçanti dokumentet e tij financiare dhe të menaxhimit të personelit, dokumente që përmbajnë të dhëna lidhur me kohën e drejtimit dhe pushimit të drejtuesit/drejtuesve të mjetit/mjeteve, si dhe çdo dokument tjetër për të cilin autoritetet e ngarkuara me ligj për kontrollin e dokumentacionit duhet të kenë akses, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim dhe aktet e tjera ligjore.

b) ketë në dispozicion të tij një ose më shumë mjete, të cilat janë regjistruar ose janë vënë në qarkullim, në përputhje me legjislacionin shqiptar, nëse këto mjete janë në pronësi ose janë nën një marrëveshje/kontratë qiramarrje ose një kontrate qirablerje, me këste.

c) drejtojë efektivisht dhe vazhdimisht me procedurat e nevojshme administrative operacionet lidhur me mjetet të përmendura në pikën 9 dhe me pajisje të përshtatshme teknike dhe ambientet e një qendre operimi të vendosur në Shqipëri.

6.2 Reputacioni i mirë

Subjekti konsiderohet me reputacion të mirë, kur plotëson kërkesat e VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar.

6.2.1 Çdo subjekt, që kërkon të ushtrojë veprimtari në transport ndërkombëtar rrugor të mallrave, duhet të deklarojë se plotëson kushtin e reputacionit të mirë nëpërmjet plotësimit të formularit të vetëdeklarimit nga përfaqësuesi ligjor dhe drejtuesi i veprimtarisë.

6.2.2 Autoriteti kompetent mund të verifikojë rast pas rasti deklaratën/deklaratat e plotësimit të kushtit të reputacionit të mirë.

6.2.3 Referuar pikës 6.2.4 më poshtë, autoriteti kompetent përcakton kushtet për t'u plotësuar nga subjektet dhe drejtuesit e veprimtarisë së transportit, me qëllim që të kënaqin kërkesat e reputacionit të mirë.

Çdo referencë në këtë pikë për dënimet, gjobat ose shkeljet do të përfshijë dënimet, gjobat ose shkeljet e vetë subjektit, të drejtuesve të veprimtarisë së transportit dhe çdo personi tjetër të përshtatshëm të përcaktuar nga autoriteti kompetent.

6.2.4. Referencat në paragrafin e mësipërm përfshijnë të paktën kushtet, si në vijim:

a) nuk ka pasur ngjarje detyruese për dyshim të reputacionit të mirë të drejtuesit të veprimtarisë të subjektit, të tilla si: dënimet ose gjobat për çdo shkelje serioze të legjislacionit dhe të rregullave në fuqi në Shqipëri, përkatësisht:

i. ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare",i ndryshuar;

ii. ligjit nr. 8901, datë 23.05.2002, "Për falimentimin";

iii. kushtet e punësimit dhe të pagesës në profesion;

iv. ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

v. përgjegjësinë profesionale;

vi. trafikimin e qenieve njerëzore ose drogave; dhe

b) drejtuesi i veprimtarisë së subjektit nuk ka qenë i dënuar në të kaluarën për një veprim të rëndë kriminal ose të këtë pësuar një ndëshkim/ gjobitje për një shkelje serioze të rregullave në veçanti, lidhur me:

i. kohën e drejtimit dhe periudhat e pushimit për drejtuesit e mjeteve, kohën e punës, si dhe instalimin dhe përdorimin e pajisjeve të regjistrimit;

ii. peshat dhe përmasat maksimale të mjeteve të përdorura në transportin ndërkombëtar;

iii. kualifikimin fillestar dhe trajnimin periodik të drejtuesve të mjeteve;

iv. kontrollet e mjeteve, përfshirë inspektimin teknik;

v. pranimin në veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave;

vi. instalimin dhe përdorimin e pajisjeve kufizuese të shpejtësisë në disa prej kategorive të mjeteve;

vii. lejet e drejtimit;

viii. transportin e kafshëve.

6.2.5 Për qëllime të pikës 6.2, nëse drejtuesi i veprimtarisë së transportit ose subjekti ka qenë dënuar për një shkelje serioze kriminale ose ka pësuar një ndëshkim për një nga shkeljet serioze, sipas lidhjes 4, autoriteti kompetent do të kryejë në mënyrë dhe në kohë të përshtatshme një procedurë të plotë administrative, e cila do të përfshijë një kontroll në ambientet e subjektit përkatës.

Rezultati i kontrollit përcakton nëse në rrethana specifike të caktuara, humbja e reputacionit të mirë duhet të përbëjë një përgjegjësi personale. Çdo gjetje e tillë do të duhet të justifikohet. Kur autoriteti kompetent nuk gjen arsye/shkak që humbja e reputacionit të mirë përbën një shkelje serioze, dënimi ose gjoba nuk do të shoqërohet me humbjen e reputacionit të mirë.

7. Qëndrueshmëria financiare

Subjekti kënaq kriterin e qëndrueshmërisë financiare kur plotëson dispozitat e kreut II.1 të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar, konkretisht shkronja "a", në pikën 5.2(a): "Jo më pak se 9000 euro, për mjetin e parë dhe 5000 euro për çdo mjet shtesë, të autorizuar për t'u përdorur në transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve".

8. Kompetenca profesionale

8.1 Subjekti konsiderohet se plotëson kërkesën në lidhje me kompetencën profesionale, kur pronari/administratori është i pajisur me certifikatën përkatëse të kompetencës profesionale (CKP) për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave, lëshuar nga:

a) DPSHTRR-ja, sipas udhëzimit nr. 1, datë 28.1.2009, "Për pajisjen me certifikatën e kompetencës profesionale të drejtuesit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor", të ndryshuar;

b) Shoqata Kombëtare e Transportuesve Ndërkombëtarë Rrugorë (ANALTIR)/Instituti i Trajnimit ANALTIR, akreditуar nga Akademia IRU (Bashkimi Ndërkombëtar i Transportit Rrugor), sipas programit të trajnimit të miratuar nga kjo Akademi dhe Kartës së Kualitetit *(Quality Charter)*, për operacionet e transportit ndërkombëtar rrugor, sipas sistemit të kuotave multilaterale ECMT/CEMT, miratuar në takimin e ministrave të transportit të vendeve anëtare të Forumit Ndërkombëtar të Transportit, mbajtur në Leipzig, më 28 maj 2015.

8.2. Nëse pronari/drejtuesi i veprimtarisë së subjektit nuk plotëson kërkesat, në përputhje me kompetencën profesionale, subjekti do të caktojë një drejtues veprimtarie transporti, sipas kërkesave të kreut II.1 të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar.

8.3 Drejtuesi i veprimtarisë së transportit

8.3.1 Çdo subjekt duhet të:

- caktojë një drejtues veprimtarie, në përputhje me dispozitat e kreut II.1 të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar;

- njoftojë brenda 15 ditëve autoritetin kompetent të lëshimit të licencës (QKB) për ndryshime të mundshme në kontraktimin e drejtuesit të veprimtarisë dhe, brenda 30 ditëve, paraqitet në QKB për të kryer ndryshimet e nevojshme.

8.3.2 Personat që punojnë në organet e transportit ose të varësisë në QKB ose në organet e kontrollit në rrugë, sipas nenit 12, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, që mbulojnë veprimtarinë e transportit rrugor dhe që janë të pajisur me certifikatën e kompetencës profesionale, nuk lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si drejtues veprimtarie në një subjekt. Shmangia nga kjo rregull përbën shkelje të reputacionit të drejtuesit të veprimtarisë dhe, shkak për heqjen e certifikatës së kompetencës profesionale.

9. Gjendja e përshtatshme e mjeteve

9.1 Gjendja e përshtatshme e mjeteve provohet nëpërmjet plotësimit të standardeve të sigurisë rrugore dhe standardeve të zhurmave dhe të ndotjes së ambientit.

9.2 Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës/certifikatës në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që subjektet mund të përdorin për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, në të njëjtat kushte mjetet në pronësi të tyre dhe mjetet me qira, të regjistruara ose të vendosura në qarkullim, në përputhje me ligjet në fuqi, me kusht që janë plotësuar/kënaqur kushtet e përcaktuara në pikën 9.4.

9.3 Për të ushtruar veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave, për shërbimet për llogari të vet, mjetet duhet të jenë të pajisura me certifikatën për veprimtarinë përkatëse, lëshuar në emër të subjektit. Certifikatat lëshohen vetëm kur

plotësohet kërkesa për gjendjen e mirë të mjeteve në përputhje me standardet e kërkuara.

9.4 Mjetet me qira

9.4.1 Për qëllime të transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave, për të tretë ose me qira dhe për llogari të vet, ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve palë në marrëveshje dypalëshe ose dhe shumëpalëshe, kuotave multilaterale ECMT/CEMT, apo edhe në vende të treta, lejohet për përdorim brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, mjet i marrë me qira, duke siguruar që:

a) mjeti është regjistruar ose vendosur në qarkullim, në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

b) kontrata lidhet vetëm për marrjen me qira të mjetit pa drejtues mjeti dhe nuk shoqërohet nga një kontratë shërbimi e përfunduar me të njëjtin subjekt, që mbulon personelin e drejtimit ose të shoqërimit;

c) mjeti i marrë me qira është në dispozicion të subjektit që e përdor atë gjatë periudhës së kontratës së qirasë;

d) mjeti i marrë me qira drejtohet nga personeli i subjektit që e përdor atë;

e) qiramarrësi është përgjegjës për operimin në kushte të sigurta të mjetit të marrë me qira. Ai kryen kontrollet e duhura para përdorimit dhe mban regjistrimet e nevojshme për përdorimin e mjetit, përfshirë mirëmbajtjen e tij;

f) qiramarrësi është përgjegjës për sigurimin e dokumenteve që duhet të mbahen në mjet, si më poshtë:

i. kopjen certifikuar të licencës/certifikatës;

ii. kopjen e kontratës midis qiramarrësit dhe qiradhënësit ose një dokument të barasvlershëm me të, duke dhënë në mënyrë të veçantë emrin e qiradhënësit, emrin e qiramarrësit, datën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe identifikimin e mjetit.

9.4.2 Një subjekt mund të marrë me qira një mjet nga një subjekt tjetër për një periudhë të përkohshme, në përputhje me afatet dhe mënyrat e përcaktuara si më poshtë:

i. subjekti mund të marrë me qira, me ose pa drejtues, një mjet transporti për rastin e mjeteve të prishur apo mjeteve që janë për riparim. Qiramarrja e mjetit mund të bëhet për aq kohë sa subjekti e sheh të arsyeshme, por jo më shumë se 3 muaj;

ii. në këtë rast, certifikata e vjetër për shërbimet për llogari të vet, me të dhënat e qiradhënësit, dorëzohet pranë autoritetit kompetent dhe për këtë mjet lëshohet certifikata e re me të dhënat e qiramarrësit;

Nuk lëshohet certifikatë e re për qiramarrësin nëse nuk dorëzohet certifikata e vjetër nga qiradhënësi;

iii. në raste emergjence civile etj. ose piku të paparashikuar të kërkesës për transport, një subjekt i pajisur me licencë merr me qira një mjet, me ose pa drejtues mjeti, për një periudhë deri sa zgjat` ose është shpallur emergjenca ose piku. Subjekti qiramarrës duhet të regjistrojë mjetin pranë QKB-së.

iv. Mjeti i marrë me qira duhet të jetë në përputhje me dispozitat e pikës 9 të këtij udhëzimi.

KAPITULLI IV
PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE/CERTIFIKATAVE

10. Dorëzimi, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave

10.1 Subjektet që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave, paraqesin kërkesën (sipas lidhjes 1), të shoqëruar me dokumentet provuese (një vendosjeje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri, reputacioni i mirë, qëndrueshmëria financiare, kompetenca profesionale), të cilat dorëzohen pranë autoritetit kompetent sipas rregullave të përcaktuara.

Në rastin e aplikimit për licencë, dokumentet paraqiten pranë QKB-së, bazuar në nenin 31, seksioni VI, i ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, të ndryshuar.

Aplikimi për licencë, së bashku me dokumentet që provojnë përmbushjen e kritereve, pasi dorëzohen në QKB, sipas procedurave standarde, shqyrtohet brenda afateve kohore të miratuara, nga autoriteti kompetent. Aktmiratimi ose mosmiratimi për lëshimin e licencës mund të jepet vetëm në përgjigje të një aplikimi nëpërmjet QKB-së.

Kërkesat që kanë lidhje me aplikimet për pajisjen me certifikata në transportin ndërkombëtar rrugor, dorëzohen në zyrën e protokollit pranë autoritetit kompetent, nëpërmjet shërbimit me postë ose me postë elektronike.

10.2 Autoriteti kompetent, nëpërmjet sektorit/specialistit përgjegjës, shqyrton aplikimet përkatëse.

10.2.1 Sektori/specialisti përgjegjës ka këto përgjegjësi dhe detyra:

a) Në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligji nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat" dhe rregulloret në zbatim të tij, merr në dorëzim nga zyra e protokollit ose e sistemit me postë elektronike dhe administron të gjitha aplikimet për licencim/certifikim etj.

b) Regjistron në regjistra të posaçëm në formë shkresore dhe elektronike çdo aplikim të ndarë sipas objektit: licencim/certifikim për herë të parë, rinovim, kërkesa për licencë të certifikuar, pezullim, lëshim dublikate, zëvendësim ose shtesë mjeti etj.

c) Kur aplikimi nuk shoqërohet me dokumentacionin provues sipas këtij udhëzimi, sektori/specialisti përgjegjës brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja në dorëzim, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, i komunikon me shkrim aplikuesit kërkesën për plotësim dokumentacioni, me shënimet përkatëse. Komunikimi me shkrim pezullon afatet e shqyrtimit të kërkesës.

d) Materiali për shqyrtimin e kërkesave nga subjektet që aplikojnë për t'u pajisur me licencë (nëpërmjet QKB-së), përgatitet nga sektori/specialisti përgjegjës për licencimin dhe vetëm për ato subjekte, të cilat kanë plotësuar dokumentacionin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Materiali duhet të jetë i plotë dhe të pasqyrojë me hollësi të gjitha elementet e nevojshme, sipas veprimtarive përkatëse.

e) Kur aplikimi rezulton të jetë i plotë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 10 ditëve pune nga marrja në dorëzim e kërkesës, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, shqyrton kërkesën dhe përgatit materialin përkatës, i cili kthehet në vendim dhe miratohet nga titullari i autoritetit ose personi i autorizuar prej tij.

f) Mbi bazën e vendimit, rast pas rasti, përgatiten shkresat përcjellëse dhe/ose në rrugë elektronike i përcillen QKB-së për miratimin ose mosmiratimin për aplikimet e paraqitura nga ana e subjekteve për pajisje me licencë për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira, sipas kërkesave përkatëse.

g) Përgatit formatet e licencave/certifikatave, sipas standardeve të miratuara (lidhja 5 dhe lidhja 6), një kopje të licencës origjinale për çdo subjekt të licencuar, e cila mbahet në zyrën e subjektit, dhe aq kopje të certifikuara të licencës sa është numri i mjeteve të paraqitura në aplikim. Kopja/kopjet e/të certifikuar/a të licencës ka/kanë të njëjtin numër lëshimi, si licenca origjinale, por me numër serial të ndryshëm, e cila/të cilat regjistrohen në REK.

10.2.2 Dokumentet për rinovimin e licencave dhe të certifikatave, paraqiten jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

10.2.3 Praktikat arkivohen në bazë të veprimtarive përkatëse, sipas rendit alfabetik të subjektit/ve, duke mbajtur shënimet e plota, të arkivimit dhe të dorëzimit të tyre. Dokumentacioni ruhet nga sektori/specialisti përgjegjës, për një periudhë 3-vjeçare dhe më pas dorëzohet në arkivin qendror të autoritetit kompetent.

10.2.4 Sektori/specialisti përgjegjës nuk duhet të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procesin e licencimit. Dokumentet provuese (në origjinal ose të njësuara me origjinalin), që janë paraqitur gjatë një aplikimi të mëparshëm dhe janë brenda afatit të vlefshmërisë nuk kërkohen të paraqiten për një aplikim të ngjashëm për të njëjtën veprimtari. Sektori/specialisti përgjegjës pranon dokumentet provuese për trajtim edhe/ose kopje.

10.2.5 Afati për shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për aplikimet nëpërmjet QKB-së është 10 ditë pune, në përputhje me VKM-në nr. 1295, datë 29.12.2009, që ndryshon VKM-në nr. 538, datë 26.5.2009. Në rastet kur bëhet e pamundur marrja e një vendimi aplikohet shtyrja e shqyrtimit të kërkesave, sipas procedurave të QKB-së, por jo më shumë se një herë dhe jo më shumë se 10 ditë pune. Në rast të kundërt aplikohet miratimi në heshtje.

10.2.6 Sektori/specialisti përgjegjës për procedurat e licencimit duhet të:

a) kërkojë çdo fillim viti informacion të detajuar nga organet e kontrollit në pikat e kalimit të kufirit, mbi operimin e subjekteve të pajisura me licencë për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, ku të jepen të dhëna mbi mjetin, kapacitetin, llojin e ngarkesës të transportuar dhe destinacionin;

b) krijojë një regjistër elektronik, me qëllim hedhjen/grumbullimin e të dhënave, për:

- subjektet të pajisura me licencë për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave;

- numrin e subjekteve dhe të mjeteve që kalojnë sipas pikave kufitare;

- shkeljet e konstatuara nga organet e kontrollit vendës dhe të huaj ndaj subjekteve shqiptare, lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tyre, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në licencë, kohën e drejtimit dhe të pushimit të drejtuesit të mjetit etj.

c) dërgojë informacion për regjistrimin në REK dhe çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë për subjektet e pajisura me licencë dhe certifikatë për llogarit e vet për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, në zbatim të udhëzimit nr. 328, datë 20.1.2017, "Mbi rregullat e hollësishme për listën e të dhënave që mbahen në regjistrin elektronik kombëtar të transportit rrugor, si dhe modalitetet e mbajtjes së tij".

10.2.7 Autoriteti kompetent i licencimit ka detyrimin:

a) të verifikojë deklaratën në plotësimin e kushtit të reputacionit të mirë për subjektin dhe drejtuesin e veprimtarisë së saj;

b) të verifikojë plotësimin në vazhdimësi të kushteve të licencimit për çdo subjekt transporti të licencuar prej tij;

c) të dërgojë të gjitha të dhënat në lidhje me licencat ose certifikatat për llogari të vet, si edhe ndryshimet që mund të ndodhin më pas, brenda 7 ditëve pune, te DPSHTRR, që bazuar në udhëzimin nr. 328, datë 20.1.2017, është mbajtësi i regjistrit elektronik kombëtar (REK).

11. Formatet e licencave dhe të certifikatave, nënshkrimi dhe data lëshimit

11.1 Licenca/kopjet e certifikuara lëshohen sipas formatit të miratuar, mbështetur në modelin e Rregullores (KE) 1072/2009, përcaktuar edhe në këtë udhëzim, përkatësisht sipas lidhjes 5.

Kopja e certifikuar e licencës, pavarësisht kohës së aplikimit lëshohet nga autoriteti kompetent me afat sa afati i licencës origjinale.

11.2 Certifikata e mjeteve për llogari të vet lëshohet bazuar në pikën 3.18(b) të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, sipas formatit të lidhjes 6 dhe nënshkruhet nga titullari i autoritetit kompetent dhe/ose personi i deleguar/caktuar prej tij.

11.3 Data e lëshimit të licencës/kopjes së certifikuar ose e certifikatës është data e nënshkrimit të tyre.

11.4 Licenca/kopjet e certifikuara dhe certifikatat janë objekt i pagesës në llogarinë e autoritetit kompetent që i lëshon ato, në bazë të tarifave të miratuara:

- për licencat, sipas VKM-së nr. 1035, datë 9.7.2008, "Për caktimin e tarifës së licencimit të subjekteve, nga MPPT&T, në fushën e punimeve të ndërtimit dhe transportit, të ndryshuar (VKM nr. 1123, datë 13.11.2009);

- për certifikatat e mjeteve për llogari të vet dhe certifikatat e mjeteve për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas shkresës nr. 13786/1, datë 27.1.2010, të ministrisë përgjegjëse për financat.

Të ardhurat që grumbullohen shënohen në një regjistër të veçantë.

KAPITULLI V
KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE

12. Dokumentet që kërkohen për t'u pajisur me licencë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira

12.1 Licenca për ushtrim veprimtarie në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira lëshohet për subjektet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, të reflektuara edhe në aneksin 1, kategoria VII.2 të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar.

12.2 Licenca për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira jep edhe të drejtën për transport rrugor mallrash brenda vendit për të tretë ose me qira.

12.3 Subjekti i paraqet autoritetit kompetent kërkesën, sipas lidhjes 1, e cila duhet të përmbajë:

- llojin e veprimtarisë që kërkohet të kryhet;

- të dhëna për identifikimin e kërkuesit dhe të personit që paraqet kërkesën;

- adresën e plotë të selisë/filialit për ushtrimin e veprimtarisë;

- dokumentin që vërteton se subjekti ka në pronësi, të paktën një mjet të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, (targën/targat e mjeteve që do përdoren) të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), shoqëruar me NUIS dytësor (certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm);

- regjistrimi në QKB (ekstrakti i QKB-së), ku në objektin e veprimtarisë të shprehet aktiviteti, transport ndërkombëtar rrugor i mallrave për të tretë ose me qira;

- plotësimi i kriterit të reputacionit të mirë për përfaqësuesin ligjor dhe/ose pronarin/pronarët e subjektit, si dhe për drejtuesin e veprimtarisë, që provohet me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, përkatësisht sipas modeleve të lidhjes 3 dhe 3/1;

- dokumenti që vërteton zotërimin e kompetencës profesionale (ÇKP), për personin që drejton veprimtarinë e transportit për subjektin që do të licencohet;

- akt që vërteton marrëdhëniet e kërkuara të punës (kontrata e punës) lidhur ndërmjet përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe drejtuesit të veprimtarisë, në rastet kur subjekti nuk plotëson kërkesën e kompetencës profesionale;

- dokumenti i qëndrueshmërisë financiare;

- lista e dokumenteve shoqëruese që duhen paraqitur.

13. Lejet multilaterale ECMT/CEMT

13.1 Licenca për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave është kusht paraprak për lëshimin e lejeve multilaterale ECMT/CEMT, bazuar në kuotat ECMT/CEMT.

13.2 Pas pajisjes me licencë, subjekti aplikon pranë ANALTIR për t'u pajisur me leje CEMT, e cila lëshohet vetëm për subjekte me eksperiencë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, jo më pak se 2 (dy) vjet.

Bazuar në "Kuota shumëpalëshe CEMT, udhëzuesi/guida e përdorimit", janë të detyrueshme të përdoren certifikatat e prodhuara, sipas anekseve 2, 4, 5 dhe 6 të kësaj guide, si më poshtë:

a) Certifikata CEMT e përputhshmërisë me kërkesat teknike dhe të sigurisë për mjete EURO. Kjo certifikatë lëshohet nga prodhuesi i mjetit ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij në vendin e regjistrimit të mjetit, sipas aneksit 4 të guidës (nga dhjetor 2012);

b) Certifikata CEMT e përputhshmërisë e rimorkios me kërkesat teknike të sigurisë, sipas aneksit 5, të guidës (nga janar 2014);

c) Certifikata CEMT e kontrollit teknik për mjetet motorike dhe rimorkiot për mjete EURO. Kjo certifikatë lëshohet nga prodhuesi i mjetit, nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij në vendin e regjistrimit të mjetit ose nga DPSHTRR-ja, sipas aneksit 6, të guidës (nga janar 2014). Gjithashtu, nga 1 janari 2015, kjo certifikatë, sipas këtij aneksi, do të përdoret edhe për kamionët/mjetet motorike me peshë maksimale të lejuar me ngarkesë më të madhe se 3.5 tonë dhe nuk kalon 6 tonë.

d) Certifikata CEMT e përputhshmërisë për kamionët me peshë maksimale të lejuar me ngarkesë më të madhe se 3.5 tonë dhe nuk kalon 6 tonë (nga 1 janar 2015);

e) Certifikata CEMT e përputhshmërisë për rimorkiot/trajlerat me peshë maksimale të lejuar me ngarkesë që nuk kalon 3.5 tonë, me kërkesat teknike dhe të sigurisë (nga 1 janar 2015);

f) Autorizimi CEMT për lëvizje ndërkombëtare/transport ndërkombëtar pa ngarkesë, sipas aneksit 2, të guidës, (nga 15 tetor 2019).

13.3 Libri i udhëtimit (karneti), duhet të jetë në gjuhën e vendit të regjistrimit me numra serialë nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar, në të cilin përfshihen certifikatat në përputhje me dispozitat teknike që kanë të bëjnë me emetimin e gazrave dhe të zhurmave dhe sigurinë që kërkohet për mjetet motorike, bazuar në guidën e sipërcituar.

Certifikatat do të kenë numër serial, në atë mënyrë që të formojnë një seri koherente. Autoriteti kombëtar mundet drejtpërsëdrejti të realizojë numërimin ose t'ia delegojë atë prodhuesit, por në të dyja rastet autoriteti kombëtar do të jetë përgjegjës për t'u siguruar që numrat e certifikatave mund të "gjurmohen", pra çdo certifikatë mund të identifikohet;

13.4 Leja ECMT/CEMT lëshohet bashkë me karnetën, e cila përdoret për të kontrolluar përdorimin e lejes ECMT/CEMT. Ajo mbahet në mjet bashkë me lejen.

13.5 Për të aplikuar sërish për lejen ECMT/CEMT, subjekti duhet të dorëzojë në zyrën e ANALTIR, lejet e përdorura dhe karnetat. Subjektet, të cilat nuk i kanë përdorur lejet ECMT/CEMT, janë të detyruara t'i kthejnë ato pranë ANALTIR, në të kundërt, humbasin të drejtën për t'u pajisur përsëri me leje, vitin pasardhës.

13.6 Lejet ECMT/CEMT, të anuluara ose të kthyera të papërdorura nga një subjekt, u jepen, për periudhën e mbetur të vlefshmërisë, subjekteve të tjera që kanë bërë kërkesë. Leja ECMT/CEMT

duhet të kthehet në zyrën përkatëse brenda 15 ditëve pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

14. Transporti ndërkombëtar rrugor i mallrave të rrezikshme

14.1 Veprimtaria e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme ushtrohet kundrejt certifikatës së mallrave të rrezikshme.

14.2 Certifikata lëshohet nga DPSHTRR-ja për çdo subjekt, të pajisur paraprakisht me licencë për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira, që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme. Subjekti paraqet:

a) formulari i autodeklarimit (plotësuar dhe vulosur nga subjekti);

b) ekstrakti i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit (QKB), i cili verifikohet nga nëpunësi i autorizuar i DRSHTRR-së;

c) leje e qarkullimit për çdo mjet (mbahet fotokopje);

d) kontratë qiraje për mjetet me qira;

e) dokument identifikimi për aplikantin ose personin e pajisur me autorizim;

f) kontrolli teknik periodik vjetor (mbahet fotokopje);

g) sipas udhëzimit nr. 6, datë 27.5.2015, "Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certifikatës së miratimit ADR, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve ADR dhe tarifat e shërbimit":

i. Certifikatën e aprovuar për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme të caktuara (sipas ADR-së), lëshuar nga DPSHTRR-ja;

ii. certifikatën e inspektimit të cisternës automobilistike për mallra të rrezikshme (model 013), lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;

h) çdo dokument që subjekti kërkues gjykon se është i dobishëm për shqyrtimin e kërkesës së tij.

14.3 Për rinovimin e certifikatës për transport mallrash të rrezikshme, kërkohen të njëjtat dokumente, sipas pikës 14.2 më lart.

15. Transporti ndërkombëtar i mallrave për llogari të vet

15.1 Veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet ushtrohet me anë të certifikatës. Kjo certifikatë lëshohet nga DPSHTRR-ja për subjekte fizike ose juridike.

15.2 Mjetet me një masë/peshë maksimale me ngarkesë deri në 1,5 tonë nuk certifikohen për veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave për llogari të vet.

16. Dokumentacioni i nevojshëm për certifikim në transportin ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet

16.1 Subjekti paraqet pranë autoritetit kompetent:

- kërkesën sipas formularit të vetëdeklarimit;
- lejen e qarkullimi;
- aktin e pronësisë mbi mjetin ose kontratën e qiramarrjes në emër të subjektit aplikues shoqëruar me regjistrimin në QKB;
- dokumentin e qëndrueshmërisë financiare;
- dokumente që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave ligjore në lidhje me standardet dhe sigurinë për mjetet;
- policë sigurimi se pronari/përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të ndryshuar;
- certifikatën e kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm;
- certifikatën e kalibrimit të tahografit;
- çdo dokument tjetër shoqërues, i cili kërkohet sipas legjislacionit të posaçëm sektorial, me kusht që këto dokumente të jenë publikuar në regjistrin informativ për kategorinë e licencës, sipas VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar;
- çdo dokument që subjekti kërkues gjykon se është i dobishëm për shqyrtimin e kërkesës së tij.

16.2 Subjekti që kërkon pajisjen me certifikatë/a sigurohet që, çdo mjet i cili kryen një shërbim, duhet të mbajë gjatë gjithë udhëtimit një certifikatë ose kopjen e saj të certifikuar/njësuar me origjinalin/noterizuar, e cila do t'u paraqitet organeve të kontrollit të autorizuar për inspektim, me kërkesën e tyre.

17. Lëshimi, pezullimi dhe heqja e licencës dhe e certifikatës

17.1 Lëshimi i licencës, certifikatës

Licenca lëshohet kur aplikanti plotëson kushtet e kapitullit III, pika 6.1 (një vendosjeje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri, reputacioni i mirë, qëndrueshmëria financiare, kompetenca profesionale).

Licenca/certifikata nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj te një subjekt tjetër.

Kopja e certifikuar e licencës lëshohet me kërkesë të subjektit, i cili ka një licencë të vlefshme

për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave dhe lëshohet një kopje për një mjet. Numri i kopjeve që lëshohen bazohet në numrin e mjeteve, të cilat janë regjistruar në emër të subjektit.

Në rastin e një çifti të kombinuar të mjeteve licenca duhet të shoqërojë mjetin motorik. Licenca mbulon kombinimin e mjeteve të shoqëruara edhe në qoftë se rimorkio ose gjysmërimorkio nuk është i regjistruar ose i autorizuar të përdorë rrugët në emër të mbajtësit të licencës ose nëse është i regjistruar ose i autorizuar të përdorë rrugët në një shtet tjetër.

Licenca duhet t'u paraqitet çdo zyrtari inspektues të autorizuar, me kërkesë të tyre.

Në rastin kur kërkon të pajiset me kopje të certifikuar të licencës, për arsye të shtimit të një mjeti ose të disa mjeteve, subjekti dorëzon dokumentet përkatëse, si më poshtë:

- kërkesën sipas formularit të vetëdeklarimit;
- lejen e qarkullimit;
- aktin e pronësisë mbi mjetin ose kontratën e qiramarrjes në emër të subjektit që zotëron licencën, shoqëruar me NUIS dytësor;
- dokumentin e qëndrueshmërisë financiare;
- dokumente që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave ligjore, në lidhje me standardet dhe sigurinë për mjetet;
- policën e sigurimit se pronari/përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të ndryshuar;
- certifikatën e kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm;
- certifikatën e kalibrimit të tahografit;
- çdo dokument tjetër shoqërues, i cili kërkohet sipas legjislacionit të posaçëm sektorial, me kusht që këto dokumente të jenë publikuar në regjistrin informativ për kategorinë e licencës, sipas VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar;
- çdo dokument që subjekti kërkues gjykon se është i dobishëm për shqyrtimin e kërkesës së tij.

17.1.1 Licenca/certifikata lëshohet, përveç rasteve kur:

a) aplikanti është i paaftë të sigurojë shërbimin me pajisjet të disponueshme për atë shërbim.

b) aplikanti nuk ka plotësuar kërkesat në lidhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi transportin rrugor dhe, në veçanti, kushtet dhe kërkesat lidhur me shërbimet e transportit ndërkombëtar të mallrave ose ka kryer shkelje serioze të legjislacionit të transportit rrugor lidhur me rregullat e aplikueshme për kohën e drejtimit dhe të periudhave të pushimit të drejtuesve të mjeteve.

c) autoriteti kompetent, mbi bazën e analizave të detajuara, është i bindur që qëllimi kryesor i shërbimit nuk është transporti i mallrave ndërmjet dy pikave të ndryshme të vendosura në territorin shqiptar dhe/ose në territorin e një shteti tjetër.

Autoriteti kompetent mund të refuzojë aplikimin vetëm mbi bazën e arsyeve të dhëna në këtë udhëzim.

17.2 Pezullimi dhe heqja e licencës/certifikatës

Në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar dhe në zbatim të nenit 12, të ligjit 10081, datë 23.2.2009, të ndryshuar, autoriteti kompetent merr masa për pezullimin ose heqjen (revokimin) e licencës/certifikatës, nëse titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

Konstatimi i mosplotësimit të kritereve apo të shkeljes së detyrimeve bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit.

Përpara marrjes së vendimit të heqjes, organi kompetent, si rregull, urdhëron ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim të titullit dhe/ose pezullimin e titullit (aktit administrativ), për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e vendimit për ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

Vendimi i pezullimit hiqet nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha detyrimet, sipas rastit.

Licenca/certifikata, si rregull, revokohen/hiqen:

a) kur rrethanat janë të tilla, që s'do të kishte kuptim apo mundësi për ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;

b) në rast të moszbatimit të urdhrave/vendimeve, brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;

c) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik, që garantohet nga titulli (akti administrativ), përkatës apo legjislacioni në fuqi.

Kur autoriteti kompetent vërteton që një subjekt i licencuar prej tij rrezikon plotësimin e

kërkesave të pikës 6, ai duhet të njoftojë zyrtarisht personin përgjegjës/përfaqësuesin ligjor ose drejtuesin e veprimtarisë së subjektit për këtë. Nëse autoriteti kompetent vëren se një ose më shumë prej kërkesave nuk plotësohet në vazhdimësi, me qëllim rregullimin e situatës, ai i jep subjektit mundësi të kufizuara kohore, si vijon:

a) një periudhë kohore 6–9 muaj për marrjen në punë të një drejtuesi zëvendësues veprimtarie, në rastin kur mbajtësi i licencës nuk përmbush kërkesën e kompetencës profesionale dhe/ose ka lidhur kontratë me një drejtues veprimtarie, i cili:

i. ndërron jetë;

ii. ndërpret veprimtarinë për arsye të paaftësisë fizike ose mendore;

iii. ndërpret veprimtarinë për arsye të tjera;

iv. nuk plotëson kërkesën e reputacionit të mirë;

v. nuk plotëson më kërkesën e kompetencës profesionale;

b) në rastin kur mbajtësi i licencës ka të punësuar dy ose më shumë drejtues veprimtarie dhe ndonjëri prej këtyre drejtuesve humbet reputacionin e mirë, autoriteti kompetent i kërkon mbajtësit të licencës zëvendësimin e drejtuesit të veprimtarisë;

c) një periudhë kohore 6–12 muaj, kur kërkesa e qëndrueshmërisë financiare nuk plotësohet, me qëllim demonstrimi që kjo kërkesë do të plotësohet përsëri në baza të qëndrueshme.

Licenca hiqet kur mbajtësi i licencës provohet, se:

a) ka paraqitur deklarime të pavërteta, informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar, në lidhje me të dhënat që kërkohen për lëshimin e licencës.

b) nuk fillon veprimtarinë brenda afatit prej 3 muajsh nga dita e lëshimit të licencës;

c) kryen shkelje të rënda e të përsëritura në lidhje me kushtet e përshkruara në licencë;

d) ka kryer shkelje serioze në përmbushjen e kërkesave të pikës 6.2.4 të këtij udhëzimi.

17.3 Procedurat për pezullimin ose heqjen e licencës ose certifikatës

Autoriteti kompetent, kur vendos për pezullimin ose heqjen e një licence/certifikate:

a) njofton mbajtësin e dokumentit përkatës për vendimin dhe arsyet, për të cilat ai ka marrë këtë vendim;

b) pezullimi ose heqja e licencës/certifikatës hyn në fuqi në fund të periudhës 21-ditore, duke filluar me ditën, që njoftimi i është dhënë mbajtësit të dokumentit përkatës.

Në rast se subjekti, brenda 30 ditëve pune nga dita e lëshimit, nuk tërheq licencën/certifikatën dhe nuk paraqet provën e pagesës, autoriteti kompetent i vlerëson automatikisht të revokuar/të hequra, bazuar në nenin 24, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, të ndryshuar.

Mbajtësi i një licence ose certifikate mund të ankimojë vendimin për pezullimin ose heqjen e dokumentit përkatës. Ankimimi i drejtohet titullarit të autoritetit kompetent, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e pezullimit ose të heqjes së licencës ose certifikatës.

Licenca ose certifikata anulohet edhe me kërkesë të vetë subjektit. Në transportin e mallrave autoriteti kompetent që ka lëshuar licencën ose certifikatën njoftohet të paktën dy muaj përpara ndërprerjes së veprimtarisë. Në kërkesën për anulimin e licencës ose certifikatës duhet të përcaktohet data e ndërprerjes së shërbimit dhe arsyet e kësaj ndërprerjeje.

18. Vendimet e autoritetit kompetent

18.1 Autoriteti kompetent, në përputhje me ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar, merr vendime që përfshijnë refuzimin e një aplikimi, pezullimin ose heqjen e një licence dhe deklarimin e papërshtatshëm të drejtuesit të veprimtarisë. Çdo vendim i marrë, shoqërohet me arsyetimin mbi shkaqet e refuzimit të aplikimit, pezullimit dhe heqjes së licencës.

18.2 Autoriteti kompetent refuzon kërkesën për licencim kur drejtuesi i veprimtarisë nuk ka plotësuar periudhën e rehabilitimit nga data që i është komunikuar dënimi ose kur dënohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në përputhje me shkronjën "a" dhe "b", të pikës 3.1, të kapitullit II, të VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar.

18.3 Para marrjes së një vendimi, sipas pikës 17.2 më lart, për shkeljet e kryera nga subjekti ose drejtuesi i veprimtarisë, autoriteti kompetent, përveç organeve të kontrollit në rrugë, sipas ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nëse është e nevojshme, grumbullon informacione që konsiderohen të rëndësishëm në veprimtarinë e transportit rrugor edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave apo institucione të tjera.

18.4 Penalitetet:

a) Shkeljet e dispozitave të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë e me masa plotësuese të pezullimit të licencës (ose të certifikatës) dhe të lejes së qarkullimit.

b) Transporti për të tretë dhe me qira kryhet kundrejt pagesës, me çmim/tarifë që mbështetet në dispozitat e ligjit nr. 7581, datë 7.7.1992, "Për çmimet dhe tarifat", të ndryshuar. Mbajtësi i licencës, pas pagesës së klientit që përdor këtë shërbim, është i detyruar ta pajisë atë me faturë tatimore si provë e ekzistencës së një kontrate mes tyre. Mosrespektimi i kësaj dispozite dënohet me masë administrative, sipas neneve 10, 68 dhe 71 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar.

c) Cilido që shfrytëzon dhe përdor një mjet për:

i. përdorim vetjak për transportin e mallrave, me përjashtim të autoveturave për përdorim vetjak të përcaktuara në lejen e qarkullimit, pa licencën/certifikatën përkatëse ose nuk respekton kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në lejen e qarkullimit, ndëshkohet me masë administrative, sipas pikave 4 dhe 5, të nenit 82, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;

ii. qiradhënie me drejtues mjeti, që nuk është caktuar për një shërbim, për të cilin është regjistruar si i tillë, ndëshkohet me masë administrative sipas pikës 4, të nenit 84, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

18.5 Ankimimi

Në rastin kur, autoriteti kompetent refuzon një kërkesë për pranimin në veprimtarinë e transportit rrugor, pezullon ose deklaron të papërshtatshëm për shkeljet e kryera nga ndërmarrja ose drejtuesi i veprimtarisë, personi i refuzuar ka të drejtë të ankimojë vendimin e marrë, në bazë të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe për procedura të mëtejshme, ai mund të ankohet në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

18.6 Dorëzimi i licencës, certifikatës së mjetit

Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë, licenca dhe/ose certifikata për llogari të vet dorëzohen pranë autoritetit kompetent, i cili i ka lëshuar. Edhe në rastet e heqjes së licencës dhe/ose certifikatës, brenda 10 ditëve pune, dokumentet e mësipërme dorëzohen pranë autoritetit kompetent.

Për pezullimin e një licence/certifikate, autoriteti kompetent njofton me shkrim mbajtësin e licencës/certifikatës që të dorëzojë këto dokumente, brenda 10 ditëve pune nga dita e njoftimit.

Nëse, një subjekt nuk dorëzon pranë autoritetit kompetent, brenda afatit të përmendur në paragrafët e mësipërm, licencën ose certifikatën e pezulluar ose të hequr, ky i fundit njofton organet përgjegjëse të kontrollit në rrugë dhe të gjitha organet e tjera të interesuara për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit.

18.7 Pavlefshmëria dhe zëvendësimi i licencës dhe i certifikatës

Zëvendësimi i licencës dhe/ose i certifikatës bëhet me kërkesë të vetë titullarit të saj, për rastet kur kërkohet ndryshim i ndonjë elementi përbërës të saj ose deklarohet e humbur, e vjedhur, e shkatërruar apo kur është dëmtuar (janë bërë të palexueshme specifikimet në të):

a) nëse licenca/certifikata ka humbur ose është vjedhur, subjekti informon menjëherë, brenda 7 ditëve pune, me shkrim autoritetin kompetent;

b) nëse licenca/certifikata e humbur gjendet, subjekti e dorëzon atë tek autoriteti kompetent.

Kur licenca/certifikata bëhet e palexueshme ose dëmtohet, ajo duhet të dorëzohet tek autoriteti kompetent.

Për rastet "a" dhe "b" të kësaj pike, autoriteti i licencimit/i certifikimit brenda një afati 10-ditor, ka detyrimin të lëshojë një certifikatë operimi zëvendësuese me të njëjtin afat vlefshmërie, kundrejt pagesës.

Në rast të ndërrimit, zëvendësimit, shitjes ose dhënies me qira të mjetit ose kur mjeti del jashtë përdorimit apo kur subjekti pezullon ose mbyll veprimtarinë e transportit, është i detyruar të dorëzojë certifikatën/at origjinale pranë autoritetit kompetent që e/i ka lëshuar.

19. Periudha e vlefshmërisë së licencës / kopjes së certifikuar dhe certifikatës

Licenca/kopja e certifikuar për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira lëshohet nga autoriteti kompetent, sipas

VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar, dhe është me afat deri në 10 vjet (në përputhje me afatin e licencës komunitare të përcaktuar në rregulloren 1072/2009).

Certifikatat e mjeteve për shërbimin për llogari të vet dhe mallrave të rrezikshme, lëshohen me afat nga 1 vit deri në 5 vjet, sipas kërkesës së subjekteve. Licenca e transportit (kopje e certifikuar/njësuar) dhe certifikata e mjetit në origjinal për shërbimin për llogari të vet/mallrave të rrezikshme, mbahen në mjet dhe janë objekt kontrolli dhe u paraqiten autoriteteve të kontrollit sa herë që u kërkohet.

KAPITULLI VI

20. Dispozita tranzitore dhe të fundit

20.1 Certifikatat të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për transport ndërkombëtar të mallrave:

a) për të tretë ose me qira, kanë afat deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi;

b) për llogarit të vet do të vazhdojnë të jenë në fuqi deri në datën e vlefshmërisë/përfundimit të tyre.

20.2 Lidhjet bashkëlidhur këtij udhëzimi janë pjesë përbërëse e tij.

20.3 Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, dispozitat përkatëse të udhëzimit nr. 15, datë 24.7.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", të ndryshuar, të cilat lidhen me transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, shfuqizohen.

20.4 Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, modeli i licencës nr. 111 dhe modelet e certifikatave nr. 211 dhe nr. 212, të udhëzimit të ministrit nr. 20, datë 10.10.2007, "Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", të ndryshuar, shfuqizohen.

20.5 Licencat për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar, lidhur me afatin dhe modelin e licencës, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Lidhja 1

Vendi _____	**KËRKESË**	*më datë,* ___/___/_____

1. **Subjekti:** ....., *Adresa*:* .....,
tel./ fax ....., *e-mail* .....,

2. **Vendi i kryerjes së veprimtarisë:** .....,

3. **Personi që paraqet kërkesën,** *(pronari / administratori / drejtuesi i veprimtarisë / personi autorizuar):*
....., *nr. ID/ pasaportës* .....,

4. **Lloji i veprimtarisë për të cilën aplikohet:** .....,
(licencë dhe/ose certifikatë)
.....,

5. **Deklaroj që për ushtrimin e aktivitetit të mësipërm zotëroj në pronësi ose me qira mjetet me targat e mëposhtme:** *(kur kërkohet në veprimtarinë që aplikohet)*

Nr.	Targa	Pronësi	Qira	Nr.	Targa	Pronësi	Qira
1.	*AA XXX AA*	+/-	+/-	*6.*	*AA XXX AF*	+/-	+/-
2.	*AA XXX AB*	+/-	+/-	*7.*	*AA XXX AG*	+/-	+/-
3.	*AA XXX AC*	+/-	+/-	*8.*	*AA XXX AH*	+/-	+/-
4.	*AA XXX AD*	+/-	+/-	*9.*	*AA XXX AI*	+/-	+/-
5.	*AA XXX AE*	+/-	+/-	*Etj.*	*AA XXX AJ*	+/-	+/-

Keni licencë dhe/ose certifikatë të mëparshme? *Po* ☐ *Jo* ☐
Nëse po, specifikoni fushat: 1. _____ *Nr.* _____, *datë* ___/___/_____
2. _____ *Nr.* _____, *datë* ___/___/_____
3. _____ *Nr.* _____, *datë* ___/___/_____

6. **Dokumente provuesuese dhe shoqëruese të dorëzuara**:**
6.1.....
6.2.....
6.3.....
6.4.....
6.5.....
Etj.....

7. **Deklaroj nën përgjegjësinë time, në emër dhe për llogari të subjektit kërkues që përfaqësoj, se:**
a) Të dhënat e deklaruara dhe dokumentat e dorëzuara janë të vërteta dhe brenda periudhës së vlefshmërisë;
b) Subjekti i transportit aplikues nuk ka asnjë pengesë ligjore për të ushtruar veprimtarinë e kërkuar;
c) Subjekti njeh dhe pranon kriteret dhe detyrimet e licencimit dhe/ose certifikimit.

8. **Jam në dijeni që:** *në rast se dokumentet për marrjen apo për të rinovuar licencën dhe/ ose certifikatën nuk dorëzohen* _____**** ditë brenda afatit të përcaktuar, unë humbas të drejtën e marrjes së licencës dhe/ ose certifikatës.*

DEKLARUESI *(Emër, Mbiemër dhe nënshkrimi i deklaruesit)* →	.....

Shënim:
1. Kur aplikanti është një person fizik ky formular plotësohet nga vetë personi. Kur aplikanti është person juridik, formulari plotësohet nga pronari/ administratori, drejtuesi i veprimtarisë që drejton aktivitetin e transportit të subjektit ose një person i autorizuar prej tyre.
2. Për çdo informacion shtesë për të cilin nuk ka vend për t'u paraqitur, përdorni një fletë të bardhë dhe pasi ta nënshkruani, bashkëlidhni këtij formulari.
** Adresa e zyrës së subjektit (e deklaruar në QKB);*
***Listohen dokumentet përkatëse për aplikim;*
****Shënohet numri i ditëve sipas afatit të përcaktuar.*

Lidhja 2

VETËDEKLARIM
I PRONARIT, ADMINISTRATORIT/ PËRFAQËSUESIT LIGJOR TË SUBJEKTIT

Bërë në ..... **më datë ___ /___/_____**

Unë i nënshkruari ..... pronar, administrator/ përfaqësues ligjor i subjektit ..... me seli në .....

Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë se:

a)Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë, *nuk jam shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të transportit rrugor (*ose në rast se ka, deklaroj: "Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit gjyqësor/ gjykatën administrative/..... (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe kam penalizim të licencës aktuale..... nga autoriteti përkatës ....., (shoqëruar me masën dhe motivin e penalizimit)".

b) Subjekti ..... i regjistruar në organet tatimore me NUIS ....., regjistruar në Regjistrin Kombëtar pranë QKB nr. ....., datë ....., me objekt veprimtarie transport ndërkombëtar rrugor të mallrave, për të cilin kërkoj të licencohem, nuk është në proçes falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj të tretëve (Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve, Organeve të Pushtetit Vendor, etj).

Deklaroj që njoh dhe zbatoj Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, VKM nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 8, datë 31.12.2020, "Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave".

DEKLARUESI

.....

(emër, mbiemër dhe nënshkrimi)

Lidhja 3

VETËDEKLARIM
I DREJTUESIT TË VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT

Bërë në ..... më datë, ___ /___/_____

Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë se:

a) ***Jam i pajisur*** me Certifikatën e Kompetencës Profesionale (CKP) për transport per transport ndërkombëtar rrugor të mallrave *nr. ....., datë* _____ /_____ /_____.

b) ***Jam drejtues i veprimtarisë*** të subjektit ..... me seli në ....., me objekt veprimtarie ...., për të cilin kërkon të licencohet.

c) Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë, *nuk jam shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të transportit rrugor (*ose në rast se ka), deklaroj: "Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit gjyqësor/ gjykatën administrative ..... (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/ dhe kam penalizim të CKP-së aktuale ..... nga autoriteti përkatës .....", (shoqëruar me masën dhe motivin e penalizimit).

d) ***Kam lidhur kontratë*** me këtë subjekt dhe mbaj përgjegjësi për:

Mirëmbajtjen e mjeteve, verifikimin e kontratave dhe dokumenteve të transportit rrugor, veprimet financiare bazë, caktimin e ngarkesave ose shërbimeve të drejtuesve dhe mjeteve, si dhe verifikimin e procedurave të sigurisë.

e) ***Deklaroj që jam i punësuar*** si drejtues veprimtarie në subjektet:

1) .....

2) .....

3) .....

f) ***Njoh dhe zbatoj*** ligjin nr. 8308 datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar; VKM nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, datë 31.12.2020, "Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave".

Jam në dijeni që, më lejohet të lidh kontratë dhe të drejtoj veprimtarinë e transportit deri në ***tre*** subjekte të ndryshme të vendosura në të njëjtin rreth me një numër të përgjithshëm maksimal prej ***36*** mjetesh, ose nëse jam punonjës i një subjekti, më lejohet të lidh kontratë edhe me një subjekt ose filial tjetër me seli brenda të njëjtit rreth me një numër të përgjithshëm maksimal prej ***36*** mjetesh të dy subjekteve.

DREJTUESI I VEPRIMTARISË

.....

(emër, mbiemër dhe nënshkrimi)

Lidhja 4

Shkeljet serioze/ më të rënda në vijim të nenit 6, pika 2), shkronja a), të Aneksit IV, të Rregullores (KE) nr. 1071/2009.

1. a) Tejkalon maksimum 6 ditë pune ose prej një marzh 25% ose më shumë.

   b) Tejkalon, gjatë periudhës ditore të punës, maksimumin e limitit të kohës ditore të drejtimit prej një marzhi 50% ose më shumë pa marrë një pushim/ndërprerje ose pa një periudhë pushimi të pandërprerë të paktën 4,5 orë.

2. Nuk ka një tahograf dhe/ ose kufizuesin e shpejtësisë, ose duke përdorur një pajisje të modifikuar e aftë të ndryshojë/ të ndërhyje regjistrimet e pajisjes regjistruese dhe/ ose kufizuesin e shpejtësisë ose fletën e regjistrimi të falsifikuara ose të dhëna të ngarkuara/transferuar nga tahografi dhe/ ose kartës së drejtuesit të mjetit.

3. Drejton mjetin pa patur një certifikatë të vlefshme të kontrollit teknik dhe/ ose me një difekt serioz, ndër të tjera sistemin e frenimit, sistemin e drejtimit, gomat, etj, që mund të krijojnë një rrezik të menjëhershëm për sigurinë rrugore.

4. Transporton mallra të rrezikshme që janë të ndaluara për transport ose transporton mallra të tilla në mënyrë të ndaluar ose të pa aprovuar ose pa identifikuar ato në mjet si mallra të rrezikshme, si rrjedhojë duke rrezikuar jetën ose mjedisin.

5. Transporton mallra pa patur leje drejtimi të vlefshme ose transporti kryhet nga një ndërmarrje transporti pa patur një licencë/ certifikatë të vlefshme.

6. Drejton mjetin me një kartë të drejtuesit të mjetit të falsifikuar, ose me një kartë të një drejtuesi, i cili nuk është mbajtësi i saj, ose që ka qenë mbajtur mbi bazën e një deklarimi fals dhe/ ose dokument të imituar.

7. Transporton mallra që kalojnë maksimumin e peshës së lejuar me ngarkesë deri në 20 % ose më shumë për mjetet pesha e lejuar me ngarkese e të cilëve kalon 12 tonët, dhe 25 % ose më shumë për mjetet pesha e lejuar me ngarkesë e të cilëve, nuk kalon 12 tonë.

Lidhja 5

Modeli Licencës

[Sipas Rregullores (BE) nr. 1072/2009]

(Ngjyra Pantone blu e lehtë 290, format DIN A4 letër celuloze, 100 - 120 g/m²)

(Faqja e parë e licencës)

Stema	**Autoriteti Kompetent (QKB)**

LICENCE Nr. .....

LICENCE No. .....

(Ose / or)

KOPJE E CERTIFIKUAR Nr. .....

CERTIFIED TRUE COPY no. .....

Për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira

(For the international carriage of goods by road for hire or reward)

Kjo licencë i jep të drejtën () .....

(this licence entitles)

.....

për t'u angazhuar në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira me anë të çdo rruge, për udhëtime ose pjesë të udhëtimeve të kryera për të tretë ose me qira brenda territoreve të Palëve Kontraktuese, siç përcaktohet në Rregulloren (KE) nr. 1072/2009 mbi rregullat e përbashkëta për hyrjen në tregun ndërkombëtar të transportit rrugor dhe në përputhje me dispozitat e përgjithshme të kësaj licence.

(to engage in the international carriage of goods by road for hire or reward by any route, for journeys or parts of journeys carried out for hire or reward within the territories of the Contracting Parties as laid down in Regulation (EC) no. 1072/2009 on common rules for access to the international road haulage market and in accordance with the general provisions of this licence)

Vërejtje të veçanta: ..... *(Particular remarks:)*	
Licenca është e vlefshme nga data: ..... *(Licence is valid from:)*	deri më datë: ..... *(To:)*
Lëshuar në: ..... *(Issued in:)*	më datë: ..... *(On:)*
..... Firma dhe vula e autoritetit kompetent *(Signature and stamp of the competent authority)*	

(1) Emri i plotë ose emri tregtar dhe adresa e plotë e subjektit.
(Full name or business name and full address of the haulier)

(Faqja e dytë e licencës)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Licenca lëshohet në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1072/2009.
(This licence is issued under Regulation (EC) No 1072/2009)

Ajo i jep të drejtën mbajtësit të angazhohet në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira me anë të çdo rruge për udhëtimet ose pjesët e udhëtimeve të kryera nga dhe për në territorin e Shqipërisë dhe, sipas rastit, sipas kushteve të përcaktuara këtu:

- ku pika e nisjes dhe pika e mbërritjes gjenden në dy vende të ndryshme, me ose pa tranzit nëpërmjet një ose më shumë vendeve (palë në marrëveshje) ose vendeve të treta;
- nga një vend në një vend të tretë ose anasjelltas, me ose pa transit përmes një ose më shumë vendeve (palë në marrëveshje) ose vendeve të treta;
- midis vendeve të treta me tranzit nëpër territorin e një ose më shumë vendeve dhe udhëtimet pa ngarkesë në lidhje me një transport të tillë.

(It entitles the holder to engage in the international carriage of goods by road for hire or reward by any route for journeys or parts of journeys carried out from and to the territory of the Albania and, where appropriate, subject to the conditions laid down herein:

- *where the point of departure and the point of arrival are situated in two different countries, with or without transit through one or more countries (parties in agreement) or third countries;*
- *from a country to a third country or vice versa, with or without transit through one or more countries (parties in agreement), or third countries;*
- *between third countries with transit through the territory of one or more countries, and unladen journeys in connection with such carriage.)*

Në rastin e transportit nga Shqipëria në një vend të tretë ose anasjelltas, kjo licencë vlen për atë pjesë të udhëtimit të kryer brenda territorit të vendeve, palë në marrëveshje. Ajo do të jetë e vlefshme në vendin e ngarkimit ose shkarkimit vetëm pas lidhjes së marrëveshjes së nevojshme ndërmjet Shqipërisë dhe vendit të tretë në fjalë në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 1072/2009.
(In the case of carriage from Albania to a third country or vice versa, this licence is valid for that part of the journey carried out within the territory of the countries, parties in agreement. It shall be valid in the country of loading or unloading only after the conclusion of the necessary agreement between Albania and the third country in question in accordance with Regulation (EC) No 1072/2009.)

Licenca është personale dhe jo e transferueshme.

Ajo mund të tërhiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, veçanërisht kur mbajtësi:

- nuk ka respektuar të gjitha kushtet për përdorimin e licencës,
- ka dhënë informacion të pasaktë në lidhje me të dhënat e nevojshme për lëshimin ose zgjatjen e afatit të licencës

(The licence is personal to the holder and is non-transferable.
It may be withdrawn by the competent authority, which issued it, notably where the holder has:

- *not complied with all the conditions for using the licence;*
- *supplied incorrect information with regard to the data needed for the issue or extension of the licence.)*

Origjinali i licencës duhet të mbahet nga subjekti.

Një kopje e njehsuar/ certifikuar e licencës duhet të mbahet në mjet. Në rastin e një çifti të kombinuar të mjeteve licenca duhet të shoqërojë mjetin motorik. Licenca mbulon kombinimin e mjeteve të shoqëruara edhe në qoftë se rimorkio ose gjysmë-rimorkio nuk është regjistruar ose autorizuar të përdorë rrugët në emër të mbajtësit të licencës ose nëse është regjistruar ose autorizuar të përdorë rrugët në një shtet tjetër.

Licenca duhet të paraqitet me kërkesë të çdo zyrtari inspektues të autorizuar.
(The original of the licence must be kept by the haulage undertaking.
A certified copy of the licence must be kept in the vehicle. In the case of a coupled combination of vehicles it must accompany the motor vehicle. It covers the coupled combination of vehicles even if the trailer or semi-trailer is not registered or authorised to use the roads in the name of the licence holder or if it is registered or authorised to use the roads in another country.
The licence must be presented at the request of any authorised inspecting officer.)

Brenda territorit të Shqipërisë, vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe çdo vendi tjetër, palë në marrëveshje, mbajtësi i licencës duhet të respektojë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në fuqi të secilit vend, veçanërisht në lidhje me transportin dhe trafikun.
(Within the territory of Albania, the Member States of the European Union and each other country, party in the agreement, the holder must comply with the laws, regulations and administrative provisions in force in that country, in particular with regard to transport and traffic.)

Lidhja 5.1

Karakteristikat e sigurisë së licencës

Licenca duhet të ketë të paktën dy nga karakteristikat e sigurisë si më poshtë:

- një hologram;
- fijet speciale në letër që bëhen të dukshme nën ndriçimin UV;
- të paktën një linjë mikroprinti (shtypja është e dukshme vetëm me një xham zmadhues e cila nuk riprodhohet nga makinat fotokopjuese);
- karaktere, simbole ose modele të prekshme;
- numërim i dyfishtë: numri serial dhe numri i lëshimit (të licencës);
- një sfond i sigurisë me motive të ndërthurura që shkëlqejnë (guilloche)* dhe të shtypur me ngjyrat e ylberit.

*



Lidhja 6

Faqja e parë e certifikatës, (Letër format A4, 100 - 120 g/m2, ngjyrë e verdhë)

AL	**Autoriteti Kompetent** *Competent Authority* .....

CERTIFIKATE
CERTIFICATE

PER TRANSPORTIN NDERKOMBETAR RRUGOR TE MALLRAVE PËR LLOGARI TË VET
FOR INTERNATIONAL CARRIAGE OF GOODS FOR OWN ACCOUNT

I LESHOHET SUBJEKTIT:
ISSUED TO THE ENTITY:

.....
Subjekti përgjegjës për operimet e transportit për llogari të vet
(Entity responsible for own account transport operation)

I nënshkruari: .....
Përgjegjës për subjektin, organizatën jo fitimprurëse ose tjerër (përshkruaj)
The undersigned:
Responsible for the entity, non profit-making-body or other (describe)

.....
Emër, mbiemër ose emri zyrtar, adresa e plotë
(Name, surname or trade name, full address)

vërteton që:
certifies that:

- shërbimi i transportit i ofruar është për qëllime jo-tregëtare dhe jo-fitimprurëse;
  the transport service provided is non-profit-making and non-comercial;
- transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse për subjektin;
  transport is only an ancillary activity for the person or entitity;
- mjeti me targa **AA XXX BB** është pronë e subjektit, ose i blerë me këste prej tij, ose është objekt i një kontrate afatgjatë qiramarrje;
  *the vehicle with number plate **AA XXXBB** is the property of the person or entity or has been obtained by them on deferred terms or is subject of a long-term leasing contract;*
- mjeti do të drejtohet nga një punonjës i subjektit ose të personit nënshkrues, ose nga vetë personi nënshkrues ose nga një person i punësuar ose vënë në dispozicion të tyre, sipas një detyrimi kontraktual.
  the vehicle will be driven by a member of staff of the undersigned person or entity, or by the undersigned in person or by personnel epmployed by, or put at the disposal of, under a contractual obligation.

.....
Nënshkrimi i personit ose përfaqësuesit
Signature of the person

..... Periudha vlefshmërisë *(Period of validity)*	..... Vendi dhe data lëshimit *(Place and date of issue)*
	..... **Nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent** *Signature and stamp of the competent authority*

(Faqja e pasme e certifikatës)

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

GENERAL PROVISIONS

1. Në kuptimin e ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, transporti për llogari të vet nënkupton operimet e transportit të kryera nga një subjekt për qëllime jo-tregëtare dhe jo-fitimprurëse, me anë të cilës:
   - veprimtaria e transportit është vetëm një veprimtari ndihmëse për subjektin;
   - mjetet e përdorur janë pronë e subjektit, ose janë të blera me këste prej saj, ose janë objekt i një kontrate qiramarrjeje afatgjatë dhe drejtohen nga një punonjës i subjektit ose të personit nënshkrues, ose nga vetë personi nënshkrues ose nga një person i punësuar ose vënë në dispozicion të subjektit, sipas një detyrimi kontraktual.

Within the meaning of the law no. 8308 of 18.03.1998, "On road transports", as amanded, own account carriage means operations carried out for non-commercial and non-profit purposes by an entity, whereby:
   - *transport activity is only an ancillary activity for the undertaking;*
   - *the vehicles used are the property of the entity, or have been obtained by that entity on deferred terms, or have been the subject of a long-term leasing contract and are driven by a member of the staff of the undersigned person or entity, or by the undersigned in person or by personnel epmployed by, or put at the disposal of the undertaking under a contractual obligation.*

2. Subjektet për llogari të vet lejohen të kryejnë operime transporti pa dallim me kusht që ato:
   - janë të autorizuar në vendin e rregjistrimit të ndërmarrin transportin e mallrave në përputhje me kushtet e hyrjes në treg të përcaktuara në legjislacionin përkatës vendas;
   - plotësojnë kërkesat ligjore mbi sigurinë rrugore për mjetet dhe drejtuesit e mjeteve sikundër përcaktohet në legjislacionin përkatës vendas.

Own account carriers are permitted to carry out transport operations without discrimination provided that they:
   - *are authorised in country of establishment to undertake carriage of goods in accordance with market access conditions laid down in relevant national legislation;*
   - *meet legal requirements on road safety concerning drivers and vehicles, as laid down, in relevant national legislation.*

3. Transportet e mallrave për llogari të vet i nënshtrohen sistemit të certifikatave.

Carriage of goods for its own account are subject to a system of certificates.

4. Certifikata i jep të drejtën mbajtësit të kryejë operime transporti ndërkombëtar rrugor të mallrave për llogari të vet. Ajo lëshohet nga autoriteti kompetent ku është rregjistruar mjeti dhe është e vlefshme gjatë gjithë udhëtimit, duke përfshirë udhëtimet transite.

The certificate entitles the holder to carry out international transport operations for own account. It is issued by competent authority where the vehicle is registered and is valid for the entire journey, including any transit journeys.

5. Pjesët përkatëse të kësaj certifikate plotësohen me shkronja që nuk fshihen në tre kopje nga personi ose përfaqësuesi i subjektit që kryen operacionin dhe nga autoriteti kompetent. Një kopje e certificates mbahet në zyrën e autoritetit kompetent, e cila e ka lëshuar atë dhe një kopje mbahet nga subjekti. Drejtuesi i mjetit mban kopjen origjinale ose të certifikuar në bordin e mjetit përgjatë gjithë udhëtimit. Ajo i paraqitet autoriteteve të zbatimit të ligjit me kërkesën e tyre.

The relevant parts of this certificate are comleted in indelible letters in triplicate by the person or the representive of the entity carrying out the operation and by the competent authority. One copy of certificate is kept by the administration and one copy by the person or entity. The driver keeps the original or a certified true copy on board the vehicle for the entire the duration of any international journeys. It is presented to the enforcement authorities on request.

6. Certifikata është e vlefshme për një periudhë maksimumi 5 (pesë) vjet.

The certificate is valid for a maximum of 5 (five) years.

UDHËZIM
Nr. 2, datë 13.1.2021

PËR VENDOSJEN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME, NË LIDHJE ME STANDARDET E MARKETIMIT DHE TË TREGTIMIT TË VEZËVE[2]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 37, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar; të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e përcaktuar në pikën 4, seksioni I, në udhëzimin nr. 22, datë 25.11.2010, "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor", dhe shkronjat "a", "b", "c", "d" dhe "e", pika 2, kapitulli I, i udhëzimit nr. 21, datë 25.11.2010, "Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore", kanë të njëjtin kuptim dhe do të zbatohen sipas rastit.

Ndërsa, përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime dhe do të zbatohen për qëllimin e këtij udhëzimi:

a) "paketë" do të thotë një mbështjellje që përmban vezë të klasave A ose B, duke përjashtuar paketimin e transportit dhe kontejnerët e vezëve industriale;

b) "shitje e lirë" do të thotë shitje me pakicë të vezëve deri te konsumatori përfundimtar, përveç atyre në pako;

c) "mbledhës" do të thotë çdo stabiliment i regjistruar në përputhje me seksionin IV, në udhëzimin nr. 22, datë 25.11.2010, "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor", për mbledhjen e vezëve nga prodhues, për shpërndarjen në një qendër paketimi, në një treg shitjeje ekskluzivisht te tregtarët me shumicë, stabilimentet e të cilëve janë aprovuar si qendra paketimi ose në industrinë ushqimore ose joushqimore;

ç) "data e shitjes" do të thotë kufiri maksimal i kohës për shitjen e produktit vezë për konsumatorin përfundimtar, sipas shkronjës "c", të pikës 1, të kapitullit II, të udhëzimit nr. 21 datë 25.11.2010, "Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore";

d) "industri ushqimore" do të thotë çdo stabiliment që prodhon produkte të vezëve të destinuara për konsum njerëzor, duke përjashtuar furnizuesit e ushqimit social;

dh) "industri joushqimore" do të thotë çdo biznes që prodhon produkte që përmbajnë vezë jo të destinuara për konsum njerëzor;

e) "furnizues masiv" nënkupton çdo stabiliment (përfshirë një automjet ose një tezgë të lëvizshme apo të palëvizshme), si restorantet, mensat, shkollat, spitalet dhe stabilimentet e kateringut, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të biznesit, ushqimi përgatitet për konsum nga konsumatori i fundit, sipas VKM-së nr. 434, datë 11.7.2018, "Për etiketimin e ushqimit dhe informimin e konsumatorit";

ë) "vezë industriale" do të thotë vezë që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor;

f) "parti vezësh" do të thotë vezë të paketuara ose jo nga i njëjti vend i prodhimit ose qendra e paketimit, e vendosur në një vend, me të njëjtën datë pjelljeje ose data e qëndrueshmërisë minimale ose data e paketimit, e njëjta mënyrë mbarështimi dhe, në rast të vezëve të klasifikuara, të njëjtin klasifikim të cilësisë dhe të peshës;

g) "ripaketim" do të thotë transferimi fizik i vezëve në një paketë tjetër ose shënjimi i ri i një pakete që përmban vezë;

gj) "vezë" do të thotë vezë me lëvore, përveç atyre të thyera, të inkubuara ose vezë të gatuara që prodhohen nga pulat e specieve Gallusgallus dhe janë të përshtatshme për konsum të drejtpërdrejtë nga njerëzit ose për përgatitjen e produkteve të vezëve;

h)"vezë të thyera" nënkupton vezët që tregojnë thyerje si të lëvozhgës ashtu edhe të membranës, duke rezultuar në ekspozimin e përmbajtjes së tyre;

i) "vezë të inkubuara" do të thotë vezë nga koha e futjes në inkubator e tutje;

j) "tregtim" do të thotë mbajtja e vezëve për qëllime të shitjes, përfshirë këtu oferta për shitje,

[2] Përafrim i pjesshëm i Rregullores së Komisionit (KE) nr. 589/2008, i 23 qershorit 2008, "Mbi vendosjen e rregullave të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) nr. 1234/2007, në lidhje me standardet e marketingut për vezët".

magazinim, paketim, etiketim, dorëzim ose ndonjë formë tjetër e transferimit, me ose pa pagesë;

k) "operator" nënkupton një prodhues dhe çdo person tjetër fizik ose juridik i përfshirë në tregtimin e vezëve;

l) "vend prodhimi" do të thotë një stabiliment që mban pula pjellëse; regjistruar në përputhje me Vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta";

ll) "qendër paketimi" do të thotë një qendër paketimi brenda kuptimit të udhëzimit nr. 21, datë 25.11.2010, "Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore", që është e autorizuar në përputhje me pikën 13 të këtij udhëzimi dhe ku vezët klasifikohen nga cilësia dhe pesha;

m) "konsumator i fundit" do të thotë konsumatori përfundimtar i një produkti ushqimor i cili nuk do të përdorë ushqimin si pjesë e ndonjë operacioni ose aktiviteti të biznesit ushqimor;

n) "kodi i prodhuesit" do të thotë numri dallues i prodhimit, sipas pikës 2, neni 19, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar.

2. Vezët klasifikohen sipas cilësisë më poshtë:

a) vezët e klasës A ose të "freskëta" janë për konsum të drejtpërdrejtë nga njerëzit dhe për t'u përdorur në industritë ushqimore ose joushqimore;

b) vezët e klasës B dorëzohen vetëm në industrinë ushqimore, sipas kërkesave të pikave 2 dhe 10, pjesa A, Kapitulli II, të udhëzimit nr. 21, datë 25.11.2010, "Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore".

3. Vezët e klasës A kanë karakteristikat cilësore të mëposhtme:

a) lëvozhga dhe kutikulë: formë normale, e pastër dhe e padëmtuar;

b) hapësira ajrore (dhoma e ajrit): lartësia jo më shumë se 6 mm, e palëvizshme; megjithatë, për vezët që tregtohen si "ekstra", nuk mund të kalojë 4 mm;

c) e verdha e vezës: e dukshme në ndriçim vetëm si hije, pa kufi të qartë, të dukshme, pak e lëvizshme me kthimin e vezës dhe rikthehet në pozicion qendror;

ç) e bardhë: e qartë, e tejdukshme;

d) embrion: zhvillim i padukshëm;

dh) lëndë e huaj: nuk lejohet;

e) erë e huaj: nuk lejohet.

4. Vezët e klasës A nuk duhet të lahen ose pastrohen, para ose pas klasifikimit, përveç siç parashikohet në pikat 7 dhe 8 të këtij udhëzimi.

5. Vezët e klasës A nuk duhet të trajtohen për konservim (ruajtje) ose të ftohen në lokale ose ambiente ku temperatura ruhet artificialisht në më pak se 5°C. Sidoqoftë, vezët të cilat janë mbajtur në një temperaturë nën 5°C gjatë transportit për jo më shumë se 24 orë ose në ambientet e shitjes me pakicë ose në anekset e tyre për jo më shumë se 72 orë nuk do të konsiderohen të ftohura.

6. Vezët e klasës B janë vezë të cilat nuk plotësojnë karakteristikat e cilësisë të parashikuara në pikën 2 të këtij udhëzimi. Vezët e klasës A që nuk i kanë më ato karakteristika klasifikohen në klasën B.

7. Autoriteti kompetent autorizon qendrat e paketimit për të larë vezët, me kusht që ato qendra të funksionojnë në përputhje me udhëzuesin për sistemet e larjes së vezëve.

8. Autoriteti kompetent do të inkurajojë zhvillimin e udhëzuesve kombëtarë për praktikat e mira, për sistemet e larjes së vezëve nga operatorët e biznesit të ushqimit, në përputhje me kapitullin V, të udhëzimit nr. 22, datë 25.11.2010, "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor".

9. Vezët e klasës A klasifikohen sipas peshës, si më poshtë:

a) XL - shumë e madhe: pesha ≥ 73 g;

b) L - e madhe: pesha ≥ 63 g dhe <73 g;

c) M - mesatare: pesha ≥ 53 g dhe <63 g;

ç) S - e vogël: pesha <53 g.

10. Klasifikimi sipas peshës tregohet me shkronjat përkatëse ose termat, siç përcaktohet në paragrafin 1 ose nga një kombinim i të dyjave, të cilat mund të plotësohen me diapazonet përkatëse të peshës. Mund të përdoren indikacione të tjera shtesë, me kusht që indikacione të tilla nuk ka të ngjarë të gabohen për shkronjat ose termat e përcaktuar në paragrafin 1 dhe të jenë në përputhje me VKM-në nr. 434, datë 11.7.2018, "Për etiketimin e ushqimit dhe informimin e konsumatorit".

11. Me përjashtim nga pika 9 e këtij udhëzimi, ku vezët e klasës A të madhësive të ndryshme paketohen së bashku në të njëjtën paketë, pesha minimale neto e vezëve duhet të jepet në gram dhe në sipërfaqen e jashtme të paketimit do të shfaqet shënimi "vezë me madhësi të ndryshme" ose terma ekuivalentë.

12. Vetëm qendrat e paketimit klasifikojnë dhe paketojnë vezët dhe i etiketojnë paketat e tyre. Vetëm stabilimentet që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim do të autorizohen si qendra paketimi.

13. Autoriteti kompetent do të autorizojë qendrat e paketimit për të klasifikuar vezët dhe do të caktojë një kod të qendrës së paketimit për çdo operator, mjediset dhe pajisjet teknike të të cilit janë të përshtatshme për klasifikimin e vezëve, sipas cilësisë dhe peshës. Asnjë pajisje e përshtatshme teknike për klasifikimin e vezëve sipas peshës nuk do të kërkohet për qendrat e paketimit që punojnë ekskluzivisht për industrinë ushqimore dhe joushqimore.

Autoriteti kompetent do t'i japë qendrës së paketimit një kod të qendrës së paketimit, sipas nenit 19, të ligjit nr. 9863, datë 21.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar.

14. Qendrat e paketimit duhet të kenë pajisjet teknike të nevojshme për të siguruar që vezët të trajtohen siç duhet. Kjo duhet të përfshijë sipas rastit:

a) pajisje të përshtatshme për ndriçim, automatike ose me personel të vazhdueshëm gjatë gjithë kohës, në mënyrë që cilësia e secilës vezë të shqyrtohet veçmas, ose pajisje të tjera të përshtatshme;

b) pajisjet për matjen e lartësisë së dhomës së ajrit;

c) pajisjet për klasifikimin e vezëve sipas peshës;

ç) një ose më shumë peshore të miratuara për peshimin e vezëve;

d) pajisjet për shenjimin e vezëve.

15. Autorizimi i referuar në pikat 12 dhe 13 të këtij udhëzimi, mund të tërhiqet në çdo kohë nëse kushtet e parashikuara në këtë udhëzim nuk plotësohen më.

16. Vezët klasifikohen, shënohen dhe paketohen brenda 10 ditëve nga çelja.

17. Vezët e tregtuara në përputhje me pikat 32 dhe 33 të këtij udhëzimi, do të klasifikohen, shënohen dhe paketohen brenda katër ditëve nga çelja.

18. Data e qëndrueshmërisë minimale referuar në pikën 27 , "d", shënohet në kohën e paketimit në përputhje me shtojcën X, të vendimit nr. 434, datë 11.7.2018, "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit".

19. Pa paragjykuar nenin 25, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar, në vendin e prodhimit, çdo paketim transporti që përmban vezë do të identifikohet nga prodhuesi, nga:

a) emri dhe adresa e prodhuesit;

b) kodi i prodhuesit;

c) numri i vezëve dhe/ose pesha e tyre;

ç) data ose periudha e pjelljes;

d) data e dërgimit.

Në rastin e qendrave të paketimit të furnizuar me vezë të paketuara nga njësitë e tyre të prodhimit, të vendosura në të njëjtin vend, identifikimi në paketimin e transportit mund të bëhet në qendrën e paketimit.

20. Informacioni i përmendur në pikën 19 do të zbatohet në paketimin e transportit dhe do të përmbahet në dokumentet shoqëruese. Një kopje e këtyre dokumenteve do të mbahet nga çdo operator ndërhyrës, të cilit i janë dorëzuar vezët. Origjinalet e dokumenteve shoqëruese mbahen nga qendra e paketimit që klasifikon vezët.

Kur një pjesë e vezëve të marra nga një mbledhës ndahet për dorëzim në më shumë se një operator, dokumentet shoqëruese mund të zëvendësohen nga etiketat e përshtatshme të kontejnerëve të transportit, me kusht që këta të fundit të përfshijnë informacionin e përmendur në pikën 19.

21. Informacioni i referuar në pikën 19, i aplikuar në paketimin e transportit nuk do të modifikohet dhe do të mbetet në paketimin e transportit deri në heqjen e vezëve për klasifikim të shpejtë, shenjimin ose përpunimin e mëtejshëm.

22. Treguesi për vezët e klasës B, do të jetë një rreth me diametër të paktën 12 mm rreth shkronjës "B" e cila është të paktën 5 mm e lartë, ose një njollë lehtësisht e dukshme me ngjyra me diametër të paktën 5 mm.

23. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi, autoriteti kompetent mund të përjashtojë operatorët nga detyrimet e shenjimit të parashikuara në pikën 22 të

këtij udhëzimi, kur vezët dorëzohen drejtpërdrejt nga vendi i prodhimit në industrinë ushqimore.

24. Në rastet e përmendura në pikën 23:

a) operatori i biznesit ku është vendosur prodhimi duhet të informojë në mënyrë të përshtatshme autoritetin kompetent për heqjen e markës përpara se të bëhet çdo dërgesë;

b) kur përjashtimi ka të bëjë me një furnizues të vendosur në një vend të tretë, vezët do të dorëzohen në industri vetëm me kusht që destinacioni i tyre përfundimtar me qëllim të përpunimit, të kontrollohet nga autoritetet kompetente të vendit që jep përjashtimin;

c) dorëzimi do të jetë nën përgjegjësinë e plotë të operatorit të industrisë ushqimore, i cili në përputhje me rrethanat merr përsipër të përdorë vezët vetëm për përpunim.

25. Paketat që përmbajnë vezë të klasës A mbajnë në sipërfaqen e jashtme lehtësisht të dukshëm dhe të lexueshëm qartë:

a) kodin e qendrës së paketimit;

b) vlerësimin e cilësisë; paketat duhet të identifikohen nga fjalët "Klasa A" ose shkronja A, qoftë i vetëm ose në kombinim me fjalën "e freskët";

c) klasifikimin e peshës në përputhje me pikën 10 të këtij udhëzimi;

ç) datën e qëndrueshmërisë minimale në përputhje me pikën 28 të këtij udhëzimi;

d) formulimi "vezë të lara" për vezët e lara, në përputhje me pikën 7 të këtij udhëzimi;

dh) kushtet specifike të magazinimit (ruajtjes), në përputhje me nenin 9, shkronjat "a" dhe "e", të vendimit nr. 434, datë 11.7.2018, "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit", me një tregues që këshillon konsumatorët të mbajnë vezët e ftohta pas blerjes.

26. Përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 23 të këtij udhëzimi, paketat që përmbajnë vezë të klasës A duhet të mbajnë në sipërfaqen e jashtme, lehtësisht të dukshëm dhe të lexueshëm qartë metodën e mbarështimit.

Për identifikimin e sistemit të prodhimit të vezëve përdoren vetëm termat e mëposhtëm:

a) për mënyrën konvencionale, kushtet e përcaktuara në pjesën A, të shtojcës I dhe vetëm nëse plotësohen kushtet përkatëse të përcaktuara në shtojcën II;

b) për prodhimin organik, kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 106/2016, "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre".

Kuptimi i kodit të prodhuesit duhet të shpjegohet mbi ose brenda paketimit. Kur pulat pjellëse mbahen në sistemet e prodhimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimin nr. 307, datë 4.7.2008, për miratimin e rregullores "Mbi përcaktimin e standardeve minimale për mbrojtjen e pulave pjellëse", identifikimi i metodës së prodhimit mund të plotësohet me indikacionin e dhënë në pjesën B, të shtojcës I të këtij udhëzimi.

27. Paketat që përmbajnë vezë të klasës B duhet të mbajnë në sipërfaqen e jashtme informacionin lehtësisht të dukshëm dhe të lexueshëm qartë;

a) kodin e qendrës së paketimit;

b) vlerësimin e cilësisë; paketat identifikohen nga fjalët "Klasa "B" ose shkronja "B";

c) datën e paketimit.

28. Data e qëndrueshmërisë minimale referuar në nenin 9, shkronja "a" dhe "b", të vendimit nr. 434, datë 11.7.2018, "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit", do të përcaktohet jo më shumë se 28 ditë pas çeljes. Kur tregohet periudha e çeljes, data e qëndrueshmërisë minimale do të përcaktohet nga dita e parë e asaj periudhe.

29. Fjalët "ekstra" ose "ekstra të freskëta" mund të përdoren si një tregues cilësor shtesë në paketimet që përmbajnë vezë të klasës A deri në ditën e nëntë pas çeljes së vezëve.

30. Kur përdoren indikacionet e përmendura në pikën 29, data e çeljes dhe afati prej nëntë ditësh duhet të tregohet në paketim, në mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht e dukshme dhe e lexueshme qartë.

31. Kur përdoret një tregues se si janë ushqyer pulat pjellëse do të zbatohen kërkesat minimale të mëposhtme:

a) mund të bëhet referencë për drithërat, si përbërës ushqimor vetëm aty ku ato përbëjnë të paktën 60% në peshë të formulës së ushqimit të dhënë, nga të cilat jo më shumë se 15% e nënprodukteve të drithërave mund të jenë pjesë e racionit;

b) pa paragjykuar minimumin e 60% të përmendur në pikën "a", kur bëhet referencë për një drithë specifik, ajo do të llogarisë të paktën 30% të formulës së ushqimit të përdorur. Nëse referimi specifik bëhet për më shumë se një prej drithërave, secila do të përbëjë të paktën 5% të formulës së ushqimit.

32. Për shitjet e lira të vezëve (të pa paketuara), informacioni i mëposhtëm duhet të jepet në një mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht e dukshme dhe e lexueshme qartë nga konsumatori:

a) vlerësimi i cilësisë;

b) klasifikimin e peshës në përputhje me pikat 9, 10 dhe 11 të këtij udhëzimi;

c) një tregues të metodës së prodhimit ekuivalente me atë të referuar në pikën 28 të këtij udhëzimi;

ç) një shpjegim të kuptimit të kodit të prodhuesit;

d) datën e qëndrueshmërisë minimale.

33. Pa paragjykuar kërkesat e përcaktuara në kapitullin X, të shtojcës II, të udhëzimit nr. 22, datë 25.11.2010, "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor", paketimet duhet të jenë rezistente ndaj goditjeve, të thata, të pastra dhe në gjendje të rregullt dhe të jenë prej materialeve që mbrojnë vezët nga aroma e jashtme dhe rreziku i përkeqësimit të cilësisë, ato përdoren vetëm një herë.

34. Vezët industriale tregtohen në kontejnerë paketimi me një shirit të kuq ose etiketë.

Shiritat ose etiketat duhet të tregojnë:

a) emrin dhe adresën e operatorit për të cilin janë destinuar vezët;

b) emrin dhe adresën e operatorit që ka dërguar vezët;

c) fjalët "vezë industriale" me shkronja të mëdha, të larta 2 cm, dhe fjalët "të papërshtatshme për konsum njerëzor" me shkronja të paktën 8 mm të larta.

35. Vezët e paketuara të klasës A mund të ripaketohen vetëm nga qendrat e paketimit. Çdo paketë duhet të përmbajë vetëm vezë të një grupi të vetëm.

36. Prodhuesit duhet të regjistrojnë informacionin mbi metodat e prodhimit, duke specifikuar për secilën metodë të përdorur të fermës:

a) datën e vendosjes, moshën e vendosjes dhe numrin e pulave pjellëse;

b) datën e shkatërrimit dhe numrin e pulave të vrara;

c) prodhimin ditor të vezëve;

ç) numrin dhe/ose peshën e vezëve të shitura në ditë ose të dorëzuara çdo ditë me mjete të tjera;

d) emrat dhe adresat e blerësve.

37. Kur metoda e ushqimit tregohet në përputhje me pikën 31 të këtij udhëzimi, prodhuesit, pa paragjykuar kërkesat e përcaktuara në pjesën A, III. Regjistrimi i të dhënave, të shtojcës I, të udhëzimit nr. 22, datë 25.11.2010, "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor", regjistrojnë informacionin e mëposhtëm, specifikuar për secilën metodë të të ushqyerit të përdorur:

a) sasia dhe lloji i ushqimit të furnizuar ose të përziera në vend;

b) datën e dorëzimit të ushqimit për kafshë.

38. Kur një prodhues përdor metoda të ndryshme mbarështimi në një vend të vetëm prodhimi, informacioni i referuar në pikat 36 dhe 37 të këtij udhëzimi do të ndahet sipas strehimit të pulave.

39. Për qëllimet e këtij neni, në vend që të mbajnë shënime të shitjeve dhe të dërgesave, prodhuesit mund të mbajnë dosje të faturave dhe shënimeve të dorëzimit të shënuara, siç tregohet në pikat 36 dhe 37 të këtij udhëzimi.

40. Mbledhësit regjistrojnë veçmas, sipas metodës së prodhimit dhe të ditës:

a) sasinë e vezëve të mbledhura, të ndara sipas prodhuesit, duke dhënë emrin, adresën dhe kodin e prodhuesit dhe datën ose periudhën e pjelljes;

b) sasinë e vezëve të dorëzuara në qendrat përkatëse të paketimit, të ndara sipas prodhuesit, duke dhënë emrin, adresën, kodin e qendrës së paketimit dhe datën ose periudhën e pjelljes.

41. Për qëllimet e këtij neni, në vend të mbajtjes së regjistrave të shitjeve dhe të dërgesave, mbledhësit mund të mbajnë dosjet e faturave dhe shënimet e dorëzimit, siç tregohet në pikën 40 të këtij udhëzimi.

42. Qendrat e paketimit regjistrojnë veçmas, sipas metodës së prodhimit dhe të ditës:

a) sasitë e marra të vezëve të paklasifikuara, të ndara sipas prodhuesit, duke dhënë emrin, adresën dhe kodin e prodhuesit dhe datën ose periudhën e pjelljes;

b) pasi vezët të jenë klasifikuar, sasitë sipas cilësisë dhe peshës;

c) sasitë e vezëve të klasifikuara, që vijnë nga qendrat e tjera të paketimit, përfshirë kodin e atyre qendrave të paketimit dhe datën e qëndrueshmërisë minimale;

ç) sasitë e vezëve të paklasifikuara të dërguara në qendrat e tjera të paketimit, të ndara sipas prodhuesit, përfshirë kodin e atyre qendrave të paketimit dhe datën ose periudhën e pjelljes;

d) numrin dhe/ose peshën e vezëve të dorëzuara, sipas cilësisë dhe peshës, datës së paketimit në rastin e vezëve të klasës B ose datës së qëndrueshmërisë minimale në rastin e vezëve të klasës A, dhe nga blerësi, me emrin dhe adresa e këtij të fundit. Qendrat e paketimit duhet të azhurnojnë të dhënat e tyre fizike të stokut, çdo javë.

43. Kur vezët e klasës A dhe paketat e tyre përmbajnë një tregues se si ushqehen pulat pjellëse, në përputhje me pikën 34 të këtij udhëzimi, qendrat e paketimit që përdorin indikacione të tilla duhet të mbajnë regjistra të veçantë në përputhje me pikën 45 të këtij udhëzimi.

44. Për qëllimet e këtij neni, në vend që të mbajnë shënime të shitjeve dhe të dërgesave, qendrat e paketimit mund të mbajnë dosjet e faturave dhe shënimet e dorëzimit të shënuara, siç tregohet në pikat 42 dhe 43 të këtij udhëzimi.

45. Regjistrimet dhe skedarët e përmendur në pikat 20 dhe 27–44 të këtij udhëzimi mbahen për të paktën 12 muaj nga data e krijimit të tyre.

46. Autoriteti kompetent kryen shërbime inspektimi për të kontrolluar pajtueshmërinë me këtë udhëzim.

47. Shërbimet e inspektimit të përmendura në pikën 46 të këtij udhëzimi do të kontrollojnë produktet e mbuluara nga ky udhëzim në faza të ndryshme të tregtimit, sipas rastit. Përveç marrjes së mostrave të rastësishme, kontrollet do të kryhen në bazë të analizës së riskut, duke marrë parasysh llojin dhe madhësinë e stabilimentit përkatës, si dhe të dhënat e kaluara të operatorit, në lidhje me pajtueshmërinë me standardet e tregtimit për vezët.

48. Për vezët e klasës A të importuara, kontrollet e parashikuara në pikën 47 të këtij udhëzimi do të bëhen në kohën e zhdoganimit dhe para lëshimit në qarkullim të lirë. Vezët e klasës B të importuara do të lejohen në qarkullim të lirë, vetëm pasi të kontrollohet në kohën e zhdoganimit, se destinacioni i tyre i fundit është industria e përpunimit.

49. Përveç marrjes së mostrave të rastësishme, operatorët do të inspektohen në një frekuencë që përcaktohet nga shërbimet e inspektimit në bazë të analizës së riskut, siç referohet në pikën 47 të këtij udhëzimi, duke marrë parasysh, të paktën:

a) rezultatet e kontrolleve të mëparshme;

b) kompleksitetin e mënyrave të tregtimit të ndjekura për vezët;

c) shkallën e segmentimit në prodhimin ose ambientet e paketimit;

ç) sasinë e vezëve të prodhuara ose të paketuara;

d) çdo ndryshim thelbësor nga vitet e mëparshme në llojin e vezëve të prodhuara ose të përpunuara ose në metodën e tregtimit.

50. Inspektimet kryhen rregullisht dhe bëhen të paparalajmëruara. Të dhënat e përmendura në pikat 27–44 të këtij udhëzimi do të vihen në dispozicion në kërkesën e parë, për shërbimet e inspektimit.

51. Vendimet nga shërbimet e inspektimit pas inspektimeve të parashikuara në pikat 46–50 të këtij udhëzimi, që tregojnë mosrespektimin e këtij udhëzimi të merren vetëm për të gjithë tufën e vezëve që është kontrolluar.

52. Kur grupi i kontrolluar konstaton se subjekti i inspektimit nuk është në përputhje me këtë rregullore, shërbimi i inspektimit do të ndalojë tregtimin ose importimin e tufës së vezëve, përveç dhe derisa të tregohet prova se është bërë në përputhje me këtë udhëzim.

53. Shërbimi i inspektimit që ka bërë kontrollin do të verifikojë nëse tufa e vezëve e refuzuar është bërë ose po bëhet që të jetë në përputhje me këtë udhëzim.

54. Tolerancat e mëposhtme lejohen gjatë kontrollit në tufën e vezëve të klasës A:

a) në qendrën e paketimit, para dërgimit: 5% të vezëve me defekte cilësore;

b) në fazat e tjera të tregtimit: 7% e vezëve me defekte të cilësisë.

55. Për vezët e tregtuara si "ekstra" ose "ekstra të freskëta", nuk lejohet asnjë tolerancë për lartësinë e dhomës së ajrit në kohën e paketimit ose importit.

56. Kur tufa e vezëve të kontrolluar përmban më pak se 180 vezë, përqindjet e referuara në pikën 57 të këtij udhëzimi do të dyfishohen.

57. Me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 11 të këtij udhëzimi, gjatë kontrollit në tufën e vezëve të klasës A, lejohet një tolerancë në lidhje me peshën për vezë. Tufat të tilla mund të përmbajnë jo më shumë se 10% të vezëve të klasave të peshës ngjitur me atë të shënuar në

paketim, por jo më shumë se 5% të vezëve të klasës tjetër të peshës më të ulët.

58. Kur tufa e vezëve të kontrolluara përmban jo më pak se 180 vezë, përqindjet e referuara në pikën 60 të këtij udhëzimi, do të dyfishohen.

59. Lejohet një tolerancë prej 20% e vezëve me shenja që janë të palexueshme në kontrollimin e tufës së vezëve dhe paketimeve.

60. Vezët e paketuara dhe të destinuara për eksport mund të bëhen në përputhje me kërkesat e ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë urdhër, në lidhje me cilësinë, markimin dhe etiketimin ose me kërkesa shtesë.

61. Vezët e importuara plotësojnë kërkesat e këtij udhëzimi dhe të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

62. Vezët e importuara duhet të shënohen qartë dhe lexueshëm në vendin e origjinës me kodin ISO 3166. Kur nuk ka garanci të mjaftueshme për ekuivalencën e rregullave, pako që përmbajnë vezë të importuara nga vendet e treta do të kenë në sipërfaqen e jashtme në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme qartë:

a) vendin e origjinës;

b) metoda e prodhimit si "standard jo i BE-së".

63. Rregullorja nr. 1, datë 25.5.2005, "Mbi mënyrat e zbatimit CEE nr. 1907/90, të Këshillit, për normat e tregtimit të zbatueshme për vezët" dhe rregullorja nr. 2, datë 25.5.2005, "Mbi disa norma të tregtimit të vezëve", shfuqizohen.

64. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe agjencitë rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve.

Udhëzimi hyn në fuqi 21 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

SHTOJCA I
PJESA A

Kërkesat e referuara në pikën 28(a), "Vezë nga pula të lira", "Vezë stalle", "Vezë nga pula kafazi".

PJESA B

Kërkesat e referuara në pikën 29(a), "Vezë të pasuruara".

SHTOJCA II
KËRKESAT MINIMALE PËR SISTEMET E PRODHIMIT PËR METODAT E NDRYSHME TË PRODHIMIT TË VEZËVE

1. Vezët nga pula të lirë "duhet të prodhohen në sistemet e prodhimit që plotësojnë të paktën kushtet e specifikuara në udhëzimin nr. 307, datë 4.7.2008, "Për miratimin e rregullores 'Mbi përcaktimin e standardeve minimale për mbrojtjen e pulave pjellëse'".

Në veçanti, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) pulat duhet të kenë qasje të vazhdueshme gjatë ditës në lëvizje në ajër të hapur. Megjithatë, kjo kërkesë nuk e ndalon një prodhues të kufizojë hyrjen për një periudhë të kufizuar kohore në orët e mëngjesit, në përputhje me praktikën e zakonshme të mirë të bujqësisë, duke përfshirë praktikën e mirë të blegtorisë. Nëse masat e miratuara sipas legjislacionit në fuqi kërkojnë që të kufizohet lëvizja e pulave në vrapime në ajër të hapur për të mbrojtur shëndetin e publikut ose të kafshëve, vezët mund të tregtohen si "vezë nga pula të lira", pavarësisht nga ky kufizim, me kusht që pulat pjellëse të mos kenë pasur akses në lëvizjet në ajër të hapur për një periudhë të vazhdueshme prej më shumë se 16 javësh. Kjo periudhë maksimale do të fillojë nga data në të cilën grupi i pulave në fjalë, të vendosura në të njëjtën kohë, në të vërtetë kishin qasje të kufizuar në lëvizjet në ajër të hapur;

b) vrapimet në ajër të hapur ku pulat kanë qasje duhet të mbulohen kryesisht me bimësi dhe të mos përdoren për qëllime të tjera përveç pemishteve, pyjeve dhe kullotjeve të bagëtive nëse kjo e fundit është e autorizuar nga autoritetet kompetente;

c) dendësia maksimale e stokut të lëvizjeve në ajër të hapur nuk duhet të jetë më e madhe se 2500

pula për hektar tokë në dispozicion të pulave ose një pule për 4 m^2 gjatë gjithë kohës. Sidoqoftë, kur të paktën 10 m^2 për pulë është në dispozicion dhe kur rotacioni praktikohet dhe pulave u jepet mundësia e hyrjes në të gjithë zonën gjatë jetës së tufës, secila hapësirë e përdorur duhet në çdo kohë të sigurojë të paktën 2.5 m^2 për pulë;

ç) drejtimet në ajër të hapur nuk duhet të shtrihen përtej një rreze prej 150 m nga hyrja më e afërt e ndërtesës. Sidoqoftë, një zgjatje deri në 350 m nga hyrja më e afërt e ndërtesës është e lejueshme, me kusht që një numër i mjaftueshëm strehëzash shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjithë hapësirën në ajër të hapur me të paktën katër strehimore për hektar.

2. "Vezët e hambarit" duhet të prodhohen në sisteme prodhimi, të cilat plotësojnë të paktën kushtet e specifikuara në udhëzimin nr. 307, datë 4.7.2008, "Për miratimin e rregullores 'Mbi përcaktimin e standardeve minimale për mbrojtjen e pulave pjellëse"'.

3. "Vezët nga pulat e kafazit" duhet të prodhohen në sistemet e prodhimit që plotësojnë të paktën kushtet e specifikuara në udhëzimin nr. 307, datë 4.7.2008, "Për miratimin e rregullores 'Mbi përcaktimin e standardeve minimale për mbrojtjen e pulave pjellëse"'.

4. Autoriteti kompetent mund të autorizojë përjashtime nga pikat 1 dhe 2 të kësaj shtojce, për stabiliment, me më pak se 350 pula pjellëse ose pula mbarështimi të rritjes, për sa u përket detyrimeve të përmendura në udhëzimin nr. 307, datë 4.7.2008, "Për miratimin e rregullores 'Mbi përcaktimin e standardeve minimale për mbrojtjen e pulave pjellëse"'.

VENDIM
Nr. 269, datë 28.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS PËR SHËRBIMIN E RIGAZIFIKIMIT NGA IMPIANTET E GNL" NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 16, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 142/12 prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-s" në Shqipëri,

konstatoi se:

- Metodologjia për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së" është hartuar si dokument në përputhje me ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe do të zbatohet për subjektet e Sistemit të GNL-së, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE dhe që:

- i përkasin sistemit kombëtar të gazit siç përcaktohet në nenin 4, pika 17, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe operojnë, mirëmbajnë e zhvillojnë një impiant GNL;

- kanë marrë miratimin për përdorimin e impianteve ekzistuese të sistemit, në përputhje me nenin 11 dhe nenin 69, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar;

- u nënshtrohen rregullave të përgjithshme për aksesin dhe sigurimin e shërbimit të rigazifikimit nga impiantet e GNL-së, sipas dispozitave të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar (nenet 68–74);

- impianti i GNL-së është i lidhur me sistemin e transmetimit;

- shkarkon dhe rigazifikon GNL-në, sipas kontratave të nënshkruara;

- Operatori i shërbimit të GNL-së do të zbatojë rregullat e kësaj metodologjie për qëllimin e përcaktimit të tarifave nga ERE. Përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën RoR;

- Operatorit të rrjetit do t'i lejohet të mbulojë kostot e justifikuara për rrjetin, si dhe një kthim mbi investimin. ERE do të miratojë tarifat e rrjetit kur të plotësohen kushtet dhe parimet e kësaj metodologjie;

- tarifat e përdorimit të rrjetit të aprovuara nga ERE do të jenë të vlefshme për një periudhë ushtrimore (1-vjeçare) për periudhën e parë rregullatore, si dhe do të jenë në përputhje me

periudhën rregullatore të zbatuar për operatorët e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes;

- shmangia nga çdo parashikim i kësaj metodologjie do të çojë në refuzimin nga ERE të aplikimit për tarifë të operatorit të GNL-së;

- tarifat e rrjetit do të llogariten dhe miratohen nga ERE në bazë të kostove të arsyeshme që operatori i GNL-së përdor për realizimin e aktivitetit dhe që janë në përputhje me këtë metodologji;

- gjithashtu, dispozitat e "Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së" do zbatohen për qëllimet e përcaktimit të të ardhurave referuese dhe tarifave për shërbimin e rigazifikimit të GNL-së të siguruar nga depozitat e GNL-së, të konsideruara strategjike të impianteve funksionale për procesin e rigazifikimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-s" në Shqipëri.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 274, datë 28.12.2020

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SEKRETARIATIT TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË, NË LIDHJE ME SHTIMIN E SHTOJCËS E, NË RREGULLAT E PËRKOHSHME PËR MEKANIZMIN BALANCUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUARA ME VENDIMIN E BORDIT NR. 193, DATË 24.11.2017

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "gj", nenit 62, nenit 76, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/17 prot., datë 24.12.2020, të drejtorive teknike,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 193, datë 24.11.2017, Bordi i ERE-s miratoi "Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike".

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me shkresën nr. 23/157 prot., datë 22.10.2019, ka ftuar ERE-n të nisë procedurën për amendimin e "Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", duke përfshirë në këtë dokument edhe shtojcën E, të përgatitur dhe të propozuar nga Sekretariati.

- Ndryshimet e propozuara nga Sekretariati adresojnë trajtimin e problematikës së ngritur nga HEC "Ashta" për trajtimin e disbalancave. HEC "Ashta" ka parashtruar pretendimin se ka konstatuar devijime midis informacionit të një dite më parë dhe shkarkimit aktual të ujit realizuar nga HEC "Vau i Dejës", duke rezultuar kjo në krijimin e devijimeve të cilat shkaktohen nga pjesëmarrës të tjerë të tregut të energjisë elektrike dhe jo nga vetë subjekti HEC "Ashta".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 21, datë 31.1.2020, vendosi: "Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit të Energjisë në lidhje me shtimin e shtojcës E në "Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë

elektrike", të miratuara me vendimin e Bordit nr. 193, datë 24.11.2017".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

- Mbështetur në pikën 5 të vendimit të lartpërmendur, e cila parashikon detyrimin për raportim dhe dokumentim çdo muaj nga ana e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), në lidhje me ecurinë e zbatimit të tyre, OST sh.a. ka raportuar në mënyre periodike në ERE lidhur me ecurinë e zbatimit të fazës *Dry Run* (pa efekte financiare) të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

- Raportet janë përcjellë në ERE nëpërmjet shkresave me nr. 5263 prot., datë 3.9.2020 dhe nr. 6006 prot., datë 9.10.2020, por edhe në adresën zyrtare të e-mail-it të ERE-s, erealb@ere.gov.al, ndërkohë që me shkresën nr. 7186 prot., datë 27.11.2020 në ERE është përcjellë Raporti i Vlerësimit.

- Nga informacioni i evidentuar në raportet e dërguara nga OST sh.a., rezultoi se përgjatë periudhës *DRY Run* të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nuk u konstatua asnjë raportim problematik lidhur me sa parashtruar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për trajtimin e problemeve të ngritura nga HEC "Ashta", që lidhen me disbalancat.

- Si dhe lartpërmendur, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike përmes vendimit nr. 106, datë 2.7.2020, hyrja në fuqi me efekte financiare e të cilave shfuqizon "Rregullat e Përkohshme për Mekanizimin Balancues të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.193, datë 24.11.2017, parashikimi ky i përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106/2020.

Sa parashtruar më sipër, shtimi i shtojcës E, propozuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, me shfuqizimin e tyre, si parashikuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, do të bënte që ky ndryshim të ishte pa efekte juridike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos miratojë kërkesën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me shtimin e shtojcës E në Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 275, datë 28.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA PËR SHTYRJE TË AFATIT TË HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 106, DATË 2.7.2020

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe 100, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/18 prot., datë 24.12.2020, të drejtorive teknike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020 "Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike", vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

- Shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), në vijim të zbatimit të këtij vendimi, me shkresën nr. 7186 prot., datë 27.11.2020 ka

përcjellë në ERE raportin e vlerësimit, si përcaktuar në pikën 3 (tre) të vendimit sipërcituar dhe, ndër të tjera, parashtron si më poshtë vijon:

1. Sistemet aktuale në OST sh.a., në momentin e hartimit, propozimit dhe miratimit të këtyre Rregullave, ishin të parashikuara për kushtet e Shqipërisë si një zonë kontrolli;

2. Zhvillimet e fundit me hapa të shpejtë në ENSTO-E, ku sipas vendimit të RGCE, të datës 29 shtator 2020, Kosova do të fillojë të funksionojë si zonë kontrolli dhe njihet marrëveshja për krijimin e Bllokut LFC Shqipëri–Kosovë (blloku AK), parashtrohen nevoja të reja për operimin e sistemit Shqiptar dhe atë të Kosovës. Referuar Udhëzuesit të Operimit të Sistemit dhe Marrëveshjes së Bllokut "AK", OST sh.a. do të jetë në rolin e liderit të bllokut, me role dhe funksione shtesë, të cilat lidhen direkt me mekanizmin balancues dhe prokurimin/aktivizimin e rezervave automatike dhe manuale, si dhe, ndër të tjera, përshtatja e programit të kompensimit në dy zona kontrolli në dallim nga operimi me një zonë;

3. Problematikat teknike të shfaqura përqendrohen në një sërë elementesh.

Ndër të tjera, OST sh.a. parashtron: "Në kushtet kur ende nuk janë konkluduar marrëveshjet përkatëse me kontraktorët e ardhshëm dhe si rrjedhojë kemi vetëm parashikime të përafërta në lidhje me afatet për realizimin e përmirësimeve të nevojshme në sistemet SCADA dhe DAMAS, dhe si pasojë dhe të afateve për të shkuar në fazën Go Live, OST sh.a. kërkon të rishikohet afati i hyrjes në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, i parashikuar në vendimin nr. 106, data 2.7.2020, duke e shtyrë atë deri në datën 30 shtator 2021".

- Lidhur me sa parashtruar nga OST sh.a., me shkresën nr. 7186 prot., datë 27.11.2020, u vlerësua se:

Blloku Rregullues Shqipëri–Kosovë:

- Siç evidentuar, Operatori i Sistemit të Transmetimit të Kosovës (KOSTT) dhe OST sh.a., në datën 26.11.2019 kanë nënshkruar marrëveshjen dypalëshe për formimin e bllokut rregullues Shqipëri–Kosovë. Në të njëjtën kohë, në datën 30.6.2020 është nënshkruar marrëveshja e re e kyçjes ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E, për të cilën OST sh.a. është në dijeni si anëtare e ENTSO-E. Në këto rrethana, OST sh.a. ka qenë në dijeni të procesit të krijimit të bllokut rregullues Shqipëri–Kosovë kohë më parë.

- Gjithashtu, në zbatim të pikës 5 (pesë), të vendimit nr. 106, datë 2.7.2020, OST sh.a. ka raportuar në mënyrë periodike në ERE lidhur me ecurinë e zbatimit të fazës *Dry Run* të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. Respektivisht, raportet janë përcjellë në ERE nëpërmjet shkresave përkatëse me nr. 5263 prot., datë 3.9.2020 dhe nr. 6006 prot., datë 9.10.2020, si dhe në adresën zyrtare të e-mail-it të ERE-s, erealb@ere.gov.al. Në komunikimet dhe raportimet periodike të bëra nga OST sh.a. nuk është evidentuar problematika e parashtruar me shkresën nr. 7186 prot., datë 27.11.2020.

- Projekti i rregullimit Fuqi–Frekuencë (LFC) ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është realizuar vite më parë në kuadër të implementimit të projektit për ndërtimin e linjës 400 kV të interkonjeksionit ndërmjet dy vendeve. Në këtë kontekst nuk ekzistojnë pengesa teknike për të vijuar operimin e Bllokut rregullues Shqipëri–Kosovë.

- Raporti i vlerësimit përmban informacion të detajuar për hapat e kryer gjatë fazës *Dry Run* nga OST sh.a., dhe konsiston në:

- procesin e regjistrimit të pjesëmarrësve në tregun shqiptar të balancimit;

- procesin e parakualifikimit të OSHB-ve;

- procesin e ankandit të angazhimit për disponueshmëri;

- procesin e ankandit të angazhimit për shpërndarje;

- procesin e aktivizimit të energjisë balancuese.

- Si evidentuar dhe më sipër, përgjatë periudhës *Dry Run*, deri në përgatitjen e raportit të vlerësimit, rezulton se OST sh.a. ka realizuar në tërësi gjithë proceset e përcaktuara në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020. Aplikimi i këtyre Rregullave përgjatë periudhës *Dry Run* ka prodhuar rezultate konkrete ku përfshihen dhe çmime për energjinë balancuese dhe për kapacitetet rezervë.

- Në të njëjtën kohë, siç evidentuar dhe në raportin e vlerësimit të paraqitur nga OST sh.a, por edhe më sipër në këtë relacion gjatë periudhës *Dry Run* nuk janë evidentuar pengesa të cilat pamundësojnë aplikimin e këtyre Rregullave. Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të

Energjisë Elektrike kanë funksionuar gjatë kësaj periudhe në të gjithë komponentët e tyre.

- Gjithashtu, si dhe evidentohet, kemi një pjesëmarrje të mirë të OSHB-ve në procesin e parakualifikimit të tyre dhe rezultojnë në përfundim të këtij procesi 4 (katër) OSHB të kualifikuara, që mund të ofrojnë shërbimet e tyre për OST sh.a., në këtë kontekst gjykojmë se Rregullat kanë arritur objektivin e tyre.

- Aktualisht, raporti i vlerësimit nuk paraqet asnjë propozim për ndryshim apo rishikim të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar nga ERE me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020.

Në përfundim, duke vlerësuar gjithë procesin e operimit të tregut balancues të energjisë elektrike në vendin tonë në periudhën *Dry Run*, u vlerësua se afati i kërkuar nga OST sh.a. prej 9 (nëntë) muajsh, deri më 30 shtator 2021, për të bërë përmirësime të nevojshme, është më i gjatë se realizimi dhe implementimi i periudhës *Dry Run* të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë, 2.7.2020, gjatë të cilit nuk janë hasur problematika që mund të pamundësonin aplikimin e këtyre Rregullave.

Në këto kushte, u vlerësua se zgjatja e afatit duhet të jetë e pjesshme pasi nuk evidentohen probleme që pamundësojnë zbatimin e këtyre Rregullave. Kjo periudhë duhet të vijojë të jetë një zgjatje e periudhës *Dry Run* (pa efekte financiare) e zbatimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, në mënyrë që OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë të vijojnë punën e nisur dhe të mos krijohen boshllëqe në këtë drejtim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranoj pjesërisht kërkesën e OST sh.a për shtyrjen e afatit të zbatimit nga pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike, pa efekte financiare (*Dry Run*) deri në datën 31.3.2021, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, "Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike".

2. OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike të vijojnë aplikimin e periudhës *Dry Run* deri në datën 31.3.2021.

3. Me përfundimin e periudhës së shprehur në pikën 1, të këtij vendimi, "Rregullat e Përkohshme për Mekanizimin Balancues të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.193, datë 24.11.2017, shfuqizohen.

4. Shoqëria OST sh.a. të raportojë dhe të dokumentojë çdo muaj në lidhje me ecurinë e zbatimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

5. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OST sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 643, datë 15.1.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës Pogradec – Tushemisht – Doganë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Pogradec.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në pikën 4, nenin 8, të ligjit nr. 11/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, 'Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik', të ndryshuar", ku "Masa e shpërblimit për pasuritë, pronë private, që shpronësohen për interes publik, për realizimin e projekteve dhe të investimeve në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, llogaritet në përputhje me parashikimet e marrëveshjes, në rastet kur atje përcaktohet edhe

mënyra e përllogaritjes së masës së shpërblimit", ku sipas përcaktimeve në Marrëveshjen e Huas nr. 8850-AL, përcaktohet mënyra dhe masa e vlerësimit në Planin e Veprimit të Risistemimit", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, personat e tretë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e plotësimit të afateve të publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Bashkinë Pogradec, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 32 024 350 (tridhjetë e dy milionë e njëzetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Etjen Xhafaj

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA RIKONSTRUKSION I RRUGËS POGRADEC-TUSHEMISHT, LOT 1, BASHKIA POGRADEC

Nr.	STATUSI JURIDIK		TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-Pogradec)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË							Dokumenti i Pronësisë	Këmbim	Kompensim	Çështje Gjygjësore të hapura	VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
	PRIVAT			Nr.	Lloji	Sip.	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"			Vegjetacioni						
Nr.	Emri Atësia Mbiemri	SHTET	Zona Kadastrale	Pas.	Pas.	totale (m^2)	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Vlera (lekë)						
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9=7*8	10	11	12=10*11	13	14	15	16	17	18=9+12+13	19
1	Safet Izet Berberi Almira Izet Berberi Sefdie Izet Shkumbini Minir Izet Berberi Kastriot Izet Berberi		8581-POGRADEC	6/541	TRUALL	1,750			-	11.40	12,000	136,800	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		136,800	
2	Pëllumb Qani Killo		8581-POGRADEC	6/581	TRUALL	381			-	23.70	15,000	355,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		355,500	
3	Fondacioni "EDU - Pro"		8581-POGRADEC	6/48	TRUALL	2,579			-	31.80	15,000	477,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		477,000	
4	Andon Shabanllari Andrea Shabanllari		8581-POGRADEC	6/52	TRUALL	905			-	15.30	14,000	214,200	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		214,200	
5		SHTET	8581-POGRADEC	6/58	TRUALL	1,437			-	20.00	-	-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë				-	
6	Genci Hodo Çoriga		8581-POGRADEC	6/91	TRUALL	296			-	7.70	10,000	77,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		77,000	

7	Flamur Hair Sinanaj		8581-POGRADEC	6/100	TRUALL	300			-	13.50	15,000	202,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		202,500	U krye rivlerësim i pasurisë më dt.30.03.2012 me vlerë 32 654 182 Lekë me ref.08010
8	Kosta Myslym Fekolli		8581-POGRADEC	6/128	TRUALL	351			-	9.80	15,000	147,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		147,000	
9	Bajame Gani Nurçellari		8581-POGRADEC	6/183	TRUALL	246.5			-	6.90	10,000	69,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		69,000	
10	Theodhoraq Janaq Tori		8581-POGRADEC	6/210	TRUALL	1,000			-	3.20	11,500.0	36,800	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		36,800	
11	Luan Demir Bitri Abdyl Demir Bitri Lule Shahin Hima Hatixhe Shahin Hima Sabrie Hima Arben Hima Etleva Hima Elda Mato (Hima) Albana Belba (Hima)		8581-POGRADEC	6/295	TRUALL	600			-	14.10	12,000.0	169,200	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		169,200	
12	Nazar Faik Berberi Pellumb Faik Berberi Daut Faik Berberi Luftie Sali Berberi Irma Qerim Berberi Gentian Qerim Berberi Ilir Qerim Berberi		8581-POGRADEC	6/303	TRUALL	409			-	10.80	14,000	151,200	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		151,200	
13		SHTET	8581-POGRADEC	6/318	TRUALL	576.8			-	18.50	-	-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë				-	
14	Suzana Adem Suli		8581-POGRADEC	6/327	TRUALL	668			-	2.70	10,000.0	27,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		27,000	

15	Ramadan Bajram Dervishaj		8581-POGRADEC	6/328	TRUALL	252			-	11.00	15,000	165,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		165,000	
16	Rexhep Raif Malellari Lavdimir Raif Malellari Ilir Raif Malellari		8581-POGRADEC	6/373	TRUALL	1,039			-	45.60	12,000.0	547,200	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		547,200	
17	Servet Irfan Minarolli Namik Qashif Myftiu Ikbal Qashif Myftiu Aishe Qashif Kaçe Nevzat Nexhip Minarolli Fatmir Nexhip Minarolli		8581-POGRADEC	6/412	TRUALL	492			-	30.10	15,000	451,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		451,500	Më dt. 23.7.2012 është kryer rivlerësim pasurie me shumën 8 118 000 Lekë, ref.nr.08223
18	Hysen Servet Minarolli Hamik Myftiu Ikbal Myftiu Anastasi Kaçe Nevzat Minarolli Fatmir Minarolli Adelina Minarolli Zhaneta Minarolli Lida Minarolli Makbule Minarolli		8581-POGRADEC	6/450	TRUALL	3,940			-	9.60	15,000	144,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		144,000	
19	Nexhmije Murat Dervishi Eni Esat Dervishi		8581-POGRADEC	6/456	TRUALL	466.6			-	21.20	15,000	318,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		318,000	
20		SHTET	8581-POGRADEC	6/472	TRUALL	388			-	13.30	-	-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë				-	
21	Vllazeria Guxholli (Suzana Guxholli etj.)		8581-POGRADEC	6/484	TRUALL	2,620			-	11.80	12,000	141,600	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		141,600	

22	Adem Vait Malellari Shpetim Vait Malellari		8581-POGRADEC	6/509	TRUALL	1,145.2			-	19.60	12,000	235,200	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		235,200	
23	Markelian Petrit Pali		8581-POGRADEC	6/520	TRUALL	162.42			-	11.30	15,000	169,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		169,500	Për BANKA KOMBËTARE GREKE
24	Markelian Petrit Pali Petrit Mitri Pali Zoica Mihal Pali		8581-POGRADEC	6/521	TRUALL	63.32			-	4.50	10,000	45,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		45,000	Rivlerësim dt.24.8.2012 me vlerë 1 044 780 Lekë, ref.08575
25	Irfan Xhevit Berberi		8581-POGRADEC	6/522	TRUALL	1,064			-	4.00	11,000	44,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		44,000	Vënie në hipotekë me kontratë hiptekore nr.699R, 155/4K, dt.05.02.2016, bllokohet pasuria ne favor të ALPHA BANK SHA, NT E.Bardhi Rivenie në hipotekë me kontratë nr.2092R, 1896K, dt.14.12.2017, në favor të ALPHA BANK SHA.
26	Irfan Xhevit Berberi		8581-POGRADEC	6/523	TRUALL	300			-	12.10	45,000	544,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		544,500	Vënie në hipotekë me kontratë hipotekore nr.8401R, 456K, dt.19.06.2014 . Përfitues Ani Besim Beçoku
27	Defrim Qani Shkulaku		8581-POGRADEC	6/570	TRUALL	175			-	21.47	15,000	322,050	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		322,050	
28	Ilirian Feridon Blaceri		8581-POGRADEC	6/573	TRUALL	647.7			-	7.30	10,000	73,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		73,000	LEJE LEGALIZIMI dt. 22.11.2017. Godine Banimi 2 kate. Sip kati përdhe 124m^2. Sip kati i pare 148.9m^2
29	Panajot Mançellari		8581-POGRADEC	10/11	TRUALL	668			-	9.72	13,000	126,360	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		126,360	

30		SHTET	8581-POGRADEC	10/19	ARË	543			-	17.64	-	-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë				-	
31	Bajram Fezollari		8581-POGRADEC	10/20	TRUALL	2,823			-	47.50	15,000	712,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		712,500	
32	Petrit Feridon Berberi		8581-POGRADEC	10/105	TRUALL	390			-	34.90	15,000	523,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		523,500	
33		SHTET	8581-POGRADEC	10/471	ARË	221			-	10.80	-	-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë				-	Mbi këtë pasuri ndodhet objekti i legalizuar nr. 10/857 vol.41 f.23
34	Shefki Qamil Seferi		8581-POGRADEC	10/645	TRUALL	300			-	28.23	15,000	423,450	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		423,450	
35	Jani Llazi Milo		8581-POGRADEC	10/699	TRUALL	150			-	6.80	15,000	102,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		102,000	Mbi këtë pasuri ndodhet objekt i legalizuar nr. 10/796-ND, vol.42, f.150
36	Safet Izet Berberi Almira Izet Berberi Sefdie Izet Shkumbini Minir Izet Berberi Kastriot Izet Berberi		8581-POGRADEC	10/784	TRUALL	2,450			-	1.40	15,000	21,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		21,000	
37	Kristo Ethem Çorra		8581-POGRADEC	12/195	TRUALL	350			-	10.40	14,000	145,600	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		145,600	

38	Alketa Namik Myftiu Artan Namik Myftiu Ikbal (Mema) Myftiu Anastasi (Aishe) Myftiu (Kaçe) Nevzat Nexhip Minarolli Fatmir Nexhip Minarolli Nadire Petrit Minarolli Aldo Bujar Minarolli Yllka Bujar Minarolli		8581-POGRADEC	12/232	TRUALL	350			-	17.60	12,500	220,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		220,000	
39	Dhimitër Guçi		8581-POGRADEC	12/347	TRUALL	1,437.7			-	6.00	13,500	81,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		81,000	
40	Albert Fazlli Dyrmishi Vasilika Kristaq Dyrmishi		8581-POGRADEC	12/348	TRUALL	335			-	24.71	13,500	333,585	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		333,585	
41	Tahir Shuaip Hoxhaj		1298-BUÇIMAS	6/1/272	TRUALL	540			-	13.90	9,000	125,100	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		125,100	
42	Jetnor Skender Rexhollari		1298-BUÇIMAS	6/2/131	ARË	600	1.50	7,000	10,500			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		10,500	
43	Luman Baftjar Dikellari		1298-BUÇIMAS	6/1/222	ARË	386	8.90	10,000	89,000			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		89,000	
44	Hysnie Hamit Sadikaj Luljeta Adem Sadikaj Shpresa Adem Sadikaj Vjollca Adem Sadikaj		1298-BUÇIMAS	6/1/12	ARË	2,130	4.40	8,000	35,200			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		35,200	

45	Syrja Sabri Haxhillari		1298-BUÇIMAS	6/1/13	ARË	1,325	6.50	10,000	65,000			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		65,000	
46	Musa Asllan Abrashi		1298-BUÇIMAS	6/1/100	TRUALL	300			-	6.10	10,000	61,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		61,000	Vënie në hipotekë me kontratë Hipotekore nr.1678R, 744K, dt.18.07.2017 në favor të ALPHA BANK sha
47	Bujar Sabri Haxhillari		1298-BUÇIMAS	6/1/103	TRUALL	300			-	12.30	10,000	123,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		123,000	Vënie në hipotekë me përfitues ALPHA BANK SHA me kontrate hipotekore nr.1581REP., 830KOL, dt.24.07.2008. Noter Thona Bicja
48	Eugen Fari Alini		1298-BUÇIMAS	6/1/328	TRUALL	660			-	77.70	9,000	699,300	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		699,300	
49	Kristo Kudret Beqiraj		1298-BUÇIMAS	6/1/275	ARË	175	5.10	9,000	45,900			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		45,900	
50	Mynever Nuri Beqiraj		1298-BUÇIMAS	6/1/271	ARË	120	21.10	7,000	147,700			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		147,700	Mbi këtë pasuri ndodhet pjesërisht ndërtesa nr, 6/1/305, vol.26, f.87. Me leje legalizimi
51	Roland Hamdi Çela Hamdi Xhemal Çela Emine Avni Aliçkolli (Kadilli)		1298-BUÇIMAS	8/1/7	TRUALL	406			-	160.30	7,500	1,202,250	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		1,202,250	
52	Liljana Fuat Baçellari (Kadilli)		1298-BUÇIMAS	8/1/5	TRUALL	809			-	76.60	7,500	574,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		574,500	
53	Bardhyl Islam Çami Eno Bardhyl Çami		1298-BUÇIMAS	8/1/3	TRUALL	620			-	136.00	7,500	1,020,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		1,020,000	

54	Rakip Xhevair Malushi		1298-BUÇIMAS	236/16	TRUALL	550			-	34.20	7,500	256,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		256,500	
55	Alfred Agim Kadilli Ilia Argjir (Agim) Kadilli		1298-BUÇIMAS	236/4	TRUALL	769			-	63.40	7,500	475,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		475,500	Rivlerësim Pasurie në dt.31.05.2017 me vlerë 1261160 Lekë, me ref. ark. 05876,
56	Emine Avni Kadilli Shpresa Avni Çela		1298-BUÇIMAS	236/11	TRUALL	421			-	102.60	7,500	769,500	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		769,500	
57	Bektash Zenel Zhiva		1298-BUÇIMAS	7/2/12	ARË	600	133.30	7,000	933,100			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		933,100	
58	Agron Nazmi Berberi		1298-BUÇIMAS	7/2/5	ARË	312	73.00	7,000	511,000			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		511,000	
59	Gume Nazmi Dushi		1298-BUÇIMAS	7/2/4	ARË	1,360	224.90	7,000	1,574,300			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		1,574,300	
60	Leonard Edmond Kadilli		1298-BUÇIMAS	7/2/3	ARË+TRUALL	1,200	78.20	8,500	664,700	22.40	8,500	190,400	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		855,100	
61	Leonard Edmond Kadilli		1298-BUÇIMAS	7/2/2	ARË	1,000	79.20	8,000	633,600			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		633,600	
62	Rafet Ferik Berberi		1298-BUÇIMAS	7/2/1	ARË	1,000	427.60	7,000	2,993,200			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		2,993,200	Plotesim dokumentacioni

63	Eduart Mentor Hoxhallari		1298-BUÇIMAS	6/2/197	ARË	503	4.00	8,000	32,000			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		32,000	
64	Admirim Mentor Hoxhallari		1298-BUÇIMAS	6/2/198	ARË	578	9.90	8,000	79,200			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		79,200	
65	Hysen Sulejman Kulla		1298-BUÇIMAS	6/2/92	TRUALL	342			-	18.20	8,500	154,700	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		154,700	
66	Strati Hysen Papa		1298-BUÇIMAS	6/2/20	ARË	1,023	8.00	7,000	56,000			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		56,000	
67	Neki File Kume		1298-BUÇIMAS	6/2/93	ARË+TRUALL	500	3.20	9,000	28,800	-	-	-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		28,800	
68	Gezim Bektash Kolonjari		1298-BUÇIMAS	6/2/16	ARË	1,080	6.00	9,000	54,000			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		54,000	
69	Albert Jashar Mukollari		1298-BUÇIMAS	6/2/289	ARË	456.6	8.40	8,500	71,400			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		71,400	
70	Genci Gani Xhyra		1298-BUÇIMAS	6/2/184	TRUALL	624.2			-	8.70	10,000	87,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		87,000	
71	Lirije Ramadan Lamlli Bledian Kujtim Lamlli Edison Kujtim Lamlli		1298-BUÇIMAS	6/2/291	ARË	847	36.80	9,000	331,200			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		331,200	

72	Artan Xhevit Shkëmbi		1298-BUÇIMAS	6/2/192	TRUALL	2,011.9			-	47.50	10,000	475,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		475,000	
73	Erjon Shaban Killo Majlinda Ferid Killo		1298-BUÇIMAS	6/2/248	ARË	500	14.77	7,500	110,775			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		110,775	
74	Erjon Shaban Killo		1298-BUÇIMAS	6/2/277	ARË	300	3.60	7,500	27,000			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		27,000	
75	Artan Xhevit Shkëmbi		1298-BUÇIMAS	6/2/169	ARË	510.6	21.80	9,000	196,200			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		196,200	
76	Petrit Belul Hyko		1298-BUÇIMAS	6/2/98	TRUALL	500			-	19.80	10,000	198,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		198,000	
77	Eqerem Kajo Capo		1298-BUÇIMAS	397/150	TRUALL	445			-	23.80	10,000	238,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		238,000	
78	SHPK "LADI KONDI" Administrator Ladimir Nazmi Kondi		1298-BUÇIMAS	397/143	TRUALL	600			-	11.50	10,000	115,000	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		115,000	Vënie në hipotekë me kontratë hipotekore nr.596R, 315K, dt. 07.05.2014, NT Thoma Bicja, favorizon NBG BANK ALBANIA SHA, kufizohet e drejta për hipotekë pasardhëse. Rivihet në hipotekë të nivelit të dytë pasuria me kontrate hipotekore nr. 367R, 189K, dt.27.02.2015 në favor të NBG BANK ALBANIAN SHA, NT Th.Bicja, kufizohet e drejta për hipotekë tjetër pasardhëse. Bllokohet pasuria në favor të NBG BANK ALBANIA SHA si Hipotekë e nivelit të dytë me kontratë hipoteke nr.138411 me nr.1042R 501/2K,

																		dt. 12.05.2015, NT E.Bardhi, kufizohet e drejta për hipotekë pasardhëse.
79	Seladin Shebi Latifllari		1298-BUÇIMAS	397/197	ARË	1,676.4	11.20	8,000	89,600			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		89,600	
80	Nazar Shebi Latifllari		1298-BUÇIMAS	397/194	ARË	1,137.6	9.90	8,000	79,200			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		79,200	
81	Neshet Shebi Latifllari		1298-BUÇIMAS	397/117	ARË	918	8.60	8,000	68,800			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		68,800	
82	Minir Shebi Latifllari		1298-BUÇIMAS	397/114	ARË	1,089	3.60	8,000	28,800			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		28,800	
83	Aleksander Panajot Balliu		1298-BUÇIMAS	8/3/79	ARË	496	20.20	7,000	141,400			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		141,400	
84	Aleksander Panajot Balliu		1298-BUÇIMAS	8/3/80	ARË	210	11.50	7,000	80,500			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		80,500	
85	Albert Shefqet Cami		1298-BUÇIMAS	8/3/110	ARË	800	58.66	7,000	410,620			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		410,620	
86	Ilia Kastrioti		1298-BUÇIMAS	8/3/144	ARË	500	18.63	7,000	130,410			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		130,410	
87	Ilia Kastrioti		1298-BUÇIMAS	8/3/145	ARË	300	43.05	7,000	301,350			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		301,350	
88	Ardian Naum Rahmani		1298-BUÇIMAS	8/3/160	ARË	700	47.60	7,000	333,200			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		333,200	

89	Ferdinand Nazif Zgjani		1298-BUÇIMAS	8/3/154	ARË	345	38.00	7,000	266,000			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		266,000	
90	Ali Mershin Jaçelli		1298-BUÇIMAS	8/3/155	ARË	925	91.00	6,500	591,500			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		591,500	
91	Merita Alla		1298-BUÇIMAS	8/3/182	ARË	600	128.90	6,500	837,850			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		837,850	
92	Osman Vait Mersinllari		1298-BUÇIMAS	8/3/183	ARË	300	85.30	6,500	554,450			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		554,450	
93	Ylli Selami Mingo		1298-BUÇIMAS	8/3/184	ARË	300	198.00	6,500	1,287,000			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		1,287,000	
94	Pajtim Jaçellari		1298-BUÇIMAS	8/3/181	ARË	968	36.20	6,500	235,300			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		235,300	
95	Myseret Nazmi Tollozhina Marsela Pëllumb Tollozhina Rezarta Pëllumb Tollozhina Rudi Pëllumb Tollozhina		1298-BUÇIMAS	19/3/13	ARË	3,224	489.40	6,500	3,181,100			-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√		3,181,100	
							2,480		**17,306,855**	**1,462.97**		**14,717,495**	**-**				**TOTALI**	**32,024,350**	**LEKË**

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 9
Datë: 2021/01/19 14:44:53
c104daad-4b21-4620-965c-a2220245fcd8

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë